



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor**

**“Specialist i Lartë në Film dhe Media”**

me profile: a. Regjisorë; b. Skenar; c. Kamera; d. Montazh.”

**i**

**Institucionit të Arsimit të Lartë:**

**“Akademia e Filmit dhe Multimedias “Marubi ”**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

- 1. Prof. Miltiadh KUTALI
- 2. Dr. Brikena SMAJLI

Shkurt, 2020




## **PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Programi i studimit të Ciklit të Parë Bachelor u hap më 2004 pranë Akademisë së Filmit Marubi dhe me VKM Nr.229, datë 2018-04-26, u riorganizua dhe iu dha status i veçantë, për vetë veçoritë që kanë lidhje me veprimtarinë akademike që zhvillon, lidhur ngushtë me procesin mësimor, atë krijues e artistik e që shoqërohet me produktin artistik. ( VKM, 229, 2018/04/ 26). Ai është hartuar duke mbajtur parasysh ngarkesën akademike të studenteve dhe garanton një shpërndarje pothuajse uniforme të ngarkesës në semestra të ndryshëm gjatë ciklit të studimit. Prania e një baze materiale, që i përgjigjet specifikave të programit të studimit të akredituar është një mbështetje serioze për përgatitjen e studentëve dhe kryerjen e procesit mësimor qoftë në planin teorik, por sidomos në atë praktik.

Institucioni është angazhuar në krijimin e një mjedisi kinematografik dhe audiovizual që u ofron studentëve dhe personelit mundësi të barabarta për përmushjen e kërkesave të mësimdhënies e mësimnxënies në kurset përkatëse dhe të gjithë programit. Mjediset e punës, labororet, sallat e leksioneve dhe seminareve. biblioteka janë lirisht të aksesueshme nga personeli për kryerjen me profesionalizëm të detyrave të tyre. Interesimi nga institucioni për kualifikim të vazhdueshëm të personelit është kërkesë e përhershme dhe e natyrshme, ndërkohë që AFMM, është pjesë e rrjetit të shkollave europiane CILECT. Kjo e bën atë një ndër institucionet e arsimit të lartë, të njohur jo vetëm brenda vendit por edhe jashtë tij dhe me impakt në prezantimin e kulturës shqiptare në botë. AFMM në mjediset e saj dhe vizionin tregon një vetëdije dhe kujdes ndaj historisë së imazhit dhe të kinematografisë shqiptare, duke shërbyer kështu jo vetëm studentëve në të tashmen, por edhe mbrojtjes dhe pasurimit të trashëgimisë kombëtare në të ardhmen.

Në drejtim të financimit të aktiviteteve, pjesëmarrjes në konkurse apo dhe në kërkimin shkencor ( për këtë institucion ai është specifik) institucioni e siguron financimin e tyre nëpërmjet pjesëmarrjes në projekte. Në bashkëpunim me CILECT AFMM ka përditësuar dhe pasuruar dhe zhvilluar kurrikulën në mënyrë që t'i përgjigjet kërkesave të shkollave të këtij rrjeti. Ajo u ka siguruar kështu studentëve një program studimi bashkëkohor. Gjatë takimit me studentët ata theksuan se kanë përfaqësuesin e tyre në mbledhjet e vendimet e departamentit, si edhe ai arrin të përcjellë informacionin apo shqetësimin në drejtuesit e institucionit. Krahas, këtij organizimi, në AFMM është i ngritur rrjeti i Alumni i Marubit, i cili është aktiv në lidhje me institucionin. Pjesëmarrja e studentëve në projektet, aktivitetet, konkurset e organizuar nga institucionet e përfshira në CILECT, provon edhe cilësinë e programit të studimit që ofrohet.





## **Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm;**

Grupi i vlerësimit të jashtëm është përzgjedhur nga lista e ekspertëve të jashtëm të vlerësimit, miratuar nga Bordi i Akreditimit. Ekspertët e përzgjedhur, Prof. Dr. Milto Kutali dhe Dr. Brikena Smajli morën pjesë në trajnimin e organizuar nga ASCAL në tetor mbi kryerjen e vlerësimit të jashtëm të programeve të studimit bazuar në standardet e reja të sigurimit të cilësisë. Nëpërmjet sistemit elektronik AMS të ASCAL, ekspertët u njohën me raportin e vlerësimit të brendshëm dhe gjithë dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga AFMM. Në datat 21-22 tetor 2019, grupi i vlerësimit të jashtëm vizitoi institucionin dhe realizoi një sërë takimesh, intervistash e vëzhgimesh me stafin akademik dhe ndihmës në mjediset e institucionit. Raporti i përgatitur përmbledh rezultatet e shqyrtimit të dokumentacionit dhe informacionit të mbledhur gjatë vizitës në Institucion. Gjatë gjithë procedurës së vlerësimit të jashtëm ekspertët e vlerësimit janë asistuar nga kordinatori teknik i ASCAL.


Më datë 23.01.2020 dërgohet institucion me anë të sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr.37. Dt.23.01.2020, draft raporti i vlerësimit të jashtëm. Institucioni ka sjellë me anë të sistemit AMS datë 27.01.2020 dhe shkresës nr.37/1, Dt.28.01.2020 komentet mbi draft raportin. GVJ pasi u njoh me komentet e institucionit mbi draft raportin e vlerësimit të jashtëm për programin e studimit në fjalë, sqaron si më poshtë:

Për komentin 1: Në faqen 2 të Draft-Raportit, tek Përmbledhje e vlerësimit të Jashtëm, citojmë: *Programi i studimit të Ciklit të Parë Bachelor u hap më 2004 pranë Arkivit Kombëtar të Filmit dhe me VKM Nr.229, datë 2018-04-26.* Ju bejmë me dije se Programi i studimit të Ciklit të Parë Bachelor u cel në 2004 pranë Akademisë së Filmit Marubi me VKM Nr.652 dt.30.09.2004, dhe me VKM Nr.229, datë 2018-04-26 u riorganizua dhe iu dha statusi i vecantë. Bashkëlidhur VKM Nr.652 dt.30.09.2004. **Raporti në këtë pikë ndryshon.**

Për komentin 2: Në faqen 11, Kriteri 2 dhe 3, në raport shkruhet *Drejtoria e Produksioneve.* Bazuar në VKM Nr.229, datë 26.04.2018 dhe në Statutin e AFMM, termi i sakte është Njësia e Produksioneve. **Raporti në këtë pikë ndryshon.**

Për komentin 3: Në faqen 12 dhe 13, Kriteri 2,3,4,5 vlerësimin e Standardid 11.3, sic edhe e kemi relatuar, mendojmë se AFMM për shumëllojshmërinë e masterklasave dhe ateljeve me pedagogë të huaj, ka një numër më të lartë të krediteve ECTS në vit dhe kjo nuk përbën desavantazh por avantazh për studentin i cili do të vazhdojë studime universitare apo profesionale të mëtejshme. Në vlerësimin tonë mënyra e vlerësimit përmes krediteve të AFMM është në përputhje të plotë me shkollat homologe si dhe është mbështetur nga Gjykata e Tiranës në vitin 2018.

GVJ: Pavarësisht natyrës së programit të studimit, mënyrës së organizimit të mësimdhënies, mendojmë se organizimi në kredite sipas sistemit të Bolonjës, pra me 180 ECTS, për program studimi duhet të jetë i standartizuar. Edhe shkollat homologe, pjesë e rrjetit CILECT, nëse kanë një traditë dhe janë të organizuara me nivele studimesh bachelor, master, etj, ndjekin të njëjtin sistem organizimi në 180 ECTS.(Ref.Të dhënat e shkollës: Animação Digital da Universidade Lusófona,





apo University of Zagreb Academy of Dramatic Art, <https://www.adu.unizg.hr/academy-of-dramatic-art/undergraduate-studies/>). **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

Për komentin 4: Në faqen 32, në Standardin IV.5, nisur jo vetëm nga përmasa institucionale por edhe nga politika e AFMM mbi privilegimin e marrëdhënieve njerëzore në raport me teknologjinë ndërvepruese, mendojmë se është një kosto e panevojshme e aktivizimit dhe mirëmbajtjes së funksionit të menaxhimit të brendshëm i cili rezulton i instaluar, por i pa aktivizuar në serverat në rrjet të akademisë. Menaxhimi i të dhënave, shpërndarja e informacionit, përpunimi i statistikave, e shumë të tjera, bëhen në mënyrë numerike gjithashtu, por jo nga një program kompjuterik i veçantë dhe i kushtueshëm, ndoshta i vlefshëm për institucione me trupë akademike e studentore me përmasë domethënëse. AFMM, mund të ketë vetëm, jo më shumë se tridhjetë studentë në një vit akademik.

GVJ: Ne konkretisht kemi konstatuar se sistemi i brendshëm i menaxhimit nuk është në veprim dhe pavarësisht nga përligjia ose jo e një sistemi të tillë për insituconin, nuk mund të shprehemi ndryshe nga ajo që kemi konstatuar. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

Për komentin 5: Në faqen 33, Standardi IV.6, Kriteri 4, mendojmë se ka një keqkuptim pasi thuhet (cit): *Theksojmë faktin se aderimi në CILECT dhe GEECT mundëson financimin në pajisje, mjete si edhe materiale të bibliotekës, mediatekës dhe filmotekës në vijimësi.* Bëjmë me dije se anëtarësia në CILECT dhe organizata të tjera, nuk rrundëson financime të këtij lloji por vetëm informacion dhe ekspertizë të përditësuar. **Raporti në këtë pikë ndryshon.**

Për komentin 6: Në faqen 36, Standardi V.3, Kriteri 5, vlejnjë të njëjtat pozita tonat, si në pikën katër të kësaj shkrese.

GVJ: I njëjti sqarim si për pikën 4. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**






**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Specialist i Lartë në Film dhe Media” me profile: a. Regjisorë; b. Skenar; c. Kamera; d. Montazh.”**

**I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR**


<b>Standardi I.1</b>				
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>				
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p>	<p>Mendimi i GVJ është se AFMM, ofron një program studimi që pason dhe pasuron trashëgiminë kinematografike shqiptare, të krijuar gjatë shek. XX. Për më tepër, programi i studimit, mbështetet në përvojat më në zë të institucioneve kinematografike në botë të rrjetit të shkollave CILECT, (<a href="https://www.cilect.org/profiles/members/3/4#.XcgU8TNKjIU">https://www.cilect.org/profiles/members/3/4#.XcgU8TNKjIU</a>) dhe kjo jo vetëm në përvojën e mësimdhënies, por edhe në përafrimin e programeve dhe të kurrikulave, si edhe në bashkëveprimin në lidhje me projekte konkurruese. Kjo i përgatit studentët në fushën e filmit dhe të medias, duke pasuruar më tej një traditë të mëhershme shqiptare dhe duke i shërbyer ruajtjes, konsolidimit dhe zhvillimit të vlerave akademike e kulturore kombëtare. AFMM bëhet edhe një zë kinematografik shqiptar, duke ndikuar kështu edhe në zhvillimin ekonomik e kulturor të vendit.</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Programi i studimit të AFMM-së është hartuar në përputhje me misionin e institucionit (<i>Ref: Statutin e AFMM-së</i>) Ai u ofron studentëve një përgatitje krijuese dhe teknike, profesionale të nivelit të lartë bashkëkohor, duke qenë se ka krijuar lidhje me programe të institucioneve simotra më të avancuarat në botë në fushën e edukimit profesional të filmit dhe të audiovizualit. Ai ka hartuar edhe programet në bashkëlidhje dhe ekspertizë me këto institucione europiane dhe amerikane si edhe ndjek dhe zbaton dora-dorës edhe synimet afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata të institucionit (<i>Ref. Doc. 4. Plan për zhvillim</i>).</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>	<p>AFMM që nga krijimin i saj, në 2004, që në Statut (<i>Ref: Statuti AFMM 2018 si edhe Doc. 4. Plan për zhvillimin</i>) përcakton misionin e institucionit, gjë që e zhvillon më tej në veprimtarinë e mëtejshme në hartimin e programeve dhe zhvillimin e procesit mësimor, me synim përgatitjen e brezave të rinj, (talente shqiptare në kinematografi dhe në mediat audiovizuale). Shkollimi dhe përgatitja e studentëve, siç u shprehen vetë gjatë takimit përmirëson cilësinë e veprimtarisë artistike të vendit, duke ndihmuar kështu edhe indirekt në zhvillimin ekonomik të vendit si edhe në promovimin e publicitetin e shoqërisë shqiptare, goftë brenda vendit, ashtu edhe në aktivitetet e ndryshme konkurruese ku kanë marrë pjesë studentët e këtij institucioni.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

**Standardi I.2**





<b>Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</b>				
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Institucioni ka përcaktuar qartë se programin e studimit e harton dhe ofron në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit, të programit të studimit dhe sasinë e studentëve (ka pak studentë), qasja ndaj tyre është individuale, me synim zhvillimin e aftësive teknike, teorike dhe artistike, që kurorëzohet me produktin kinematografik të studentit apo atë audiovizual. Mbi dinamikën e ndryshimeve, të hartimit dhe zhvillimit të programit në përshtatje edhe me institucionet simotra në botë, pjesë përbërëse e rrjetit CILECT (Ref: Memo 14.5) si edhe (Doc. Plan per Zhvillimin).			
<b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Statuti dhe rregullorja janë të ndryshuara dhe të miratuara përkatësisht në Qershor 2018 (Ref: Doc. 2. Statuti) dhe Tetor 2018 (Ref: Doc. 5. Rregullorja) dhe ne nuk mund të gjykojmë në lidhje me ecurinë e mëparshme apo përputhshmërinë e statutit, rregullores dhe programit, por në vizitë, gjatë prezantimeve, pyetje-përgjigjeve, referimi ndaj rregullores dhe statutit të institucionit e bënte të vetëkuptueshme konstatimin tonë, se si drejtimit prioritar të institucionit, shprehur në statut dhe në rregulloren e studimit, kishin gjetur zbatim në procesin e hartimit të programeve dhe në mësimdhënie. Vetë RVB e vë në dukje këtë fakt, duke u ndalur në nenet që i kanë konsideruar të vlefshme për të theksuar (Neni 5 “Qëllimi dhe objektivat”, tek Statuti dhe për Rregulloren: Kreu III “Studimet Universitare”, Kreu IV “Njësia e Produksioneve”, dhe Kreu VII “Të drejtat dhe detyrat e studentit”) të cilat përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike dhe profesionale të AFMM-së.			
<b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ofrohet në përputhje me fushat dhe drejtimit akademike të institucionit. Këtë e vërejmë qoftë në lidhje mes emërimit të programit dhe strukturës se si ai ofrohet dhe si është organizuar nga viti i parë tek i treti, por edhe në një vështrim të imtësishëm një për një të kurseve që ofrohen në programin përkatës. Vetë personeli akademik që jep mësim, përveç cilësisë së mësimdhënies të disiplinës përkatëse karakterizohet edhe nga pasioni e cilësi të veçanta të fushës që mbështet në ekspertizë. Kështu mund të përmendim vetë drejtuesin e AFMM, z. K. Ç, apo regjisorin V. P dhe P. M, apo poeten e mirënjohur L.LI, studiuesin dhe piktorin Z. P etj. Duke ndjekur e përafuar programin (në strukturë dhe kurse) me institucionet simotra në botë, programi u ofrohet studentëve kështu i mirëstrukturuar dhe me përmbajtje bashkëkohore duke bashkëlidhur përvojat më të mira shqiptare me ato botërore (Ref. Përshkrimet e syllabuseve në shtojcën e dokumenteve)			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>





<b>Standardi I.3</b>				
<b>Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.</b>				
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.	Programi i studimit përcakton qartë synimin për formimin e studentëve në këtë program, por duhet të detajohet në mënyrë që në të, të përfshihen më të plota dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit. Sigurisht, në program në tërësi, si edhe në përmbajtjen e kurseve në veçanti vihet në dukje, struktura me një raport të caktuar mes teorisë dhe praktikës, me qëllim finalizimin e një produkti kinematografik dhe audioviziv, por kjo sidomos në syllabuse lipset të paraqitet dhe përcaktohet me uniformitet, objektiva të përgjithshme dhe objektiva të veçanta. (Ref. Plani Mësimor dhe Syllabuset).			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.	GVJ konstaton se institucioni ndjek tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programin e studimit që ai ofron. Kjo jo e kryer nëpërmjet një studimi të mirëfilltë të tregut, por nëpërmjet ndjekjes dhe evidentimit të studentëve të punësuar apo pjesëmarrës në aktivitete ndërkombëtare. AFMM ka të organizuar rrjetin Alumni si edhe ka ndërtuar bashkëpunime me alumnet e e saj ndër vite. Nga të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës, AFMM jep ndihmesë dhe shpesh pozicionohet si partnere. (Ref: doc. 17a Formular Alumnis dhe doc. 17b Alumnis_Fusha, si edhe doc 29 Të dhëna për punësimin e studentëve) Po kështu nënvizojmë faktin se institucioni ka vënë në punë edhe një praktikë të mirë në drejtim të aktivizimit të studentëve të vet të suksesshëm në mësimdhënie. (Rasti i pedagoges Msc. B. Y)			
<b>Kriteri 3.</b> Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përfitim të dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.	Objektivat formuese dhe sidomos, përmbajtja e programit, krijojnë kushte për përfitim të dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës. Studentët, duke përdorur teknologjinë dhe metodologjinë bashkëkohore punojnë dhe realizojnë produksione kinematografike, brenda punëve të kursit. Për këto “AFMM zbaton, përditëson dhe merr pjesë aktivisht në hatimin e strategjive të zhvillimit të shkollave simotra në Evropë dhe botë përmes anëtarësisë së saj në CILECT dhe GEECT” (Ref:RVB) si e dhe (doc.39, admission courseöork and diploma assessment criteria geect conference)			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

**Standardi I.4**  
**Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë**



<b>përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</b>				
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvijën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.	Institucioni ka përvijën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike me profesorë vendas dhe të huaj. Ai ka në përbërje të tij, profesionistë me profil të spikatur në fushat që ata mbulojnë. Këtë e mbështesim duke iu referuar jetëshkrimin të stafit pedagogjik të institucionit. (Ref: Cv-të e personelit akademik)			
<b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, kinematografisë dhe asaj audiovizuale, e cila siç na u referua gjatë vizitës dhe siç shënohet edhe në RVB mbikëqyret nga njësi bazë, Njësia e Produksioneve dhe që në lidhje me zhvillimin kurrikulës, sjell dhe pasqyron vazhdimisht përditësimet sipas rekomandimeve dhe të rejave nga CILECT në nivel global dhe GEECT në nivel evropian." (RVB; f. 6) Po kështu, për ndryshimet kurrikulare dhe argumentimin (Doc. 14a, 14b, 14d, Lista e ndryshimeve) si dhe Memorandumet e Mirëkuptimit (MoU 34, të tre institucioneve, përkatësisht: MoU IFS rënëal 2014 MoU Shk Don Bosco 2019, MoU Stavracos-Marubi 2019)			
<b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore. Në rastin e AFMM, viti i parë i studimeve, pavarësisht profileve, siç na u pohua gjatë vizitës, por edhe në (14a, 14b Planet mësimore) dhe RVB, theksohet karakteri i përgjithshëm formues i programit. Për të vazhduar më tej në dy vitet e tjera, ku, fushat e specialitetit marrin edhe përgjigje konkrete në lëndët apo kurset specifike që ndjek studenti. E gjitha bëhet nën "koordinimin e Njësive të Produksioneve, bazuar në Statusin dhe Rregulloren e Akademisë Marubi." (RVB; f. 6)			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi I.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes	Institucioni siguron marrëdhënie bashkëpunimi institucionale nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. Kjo është e shprehur qartë edhe në statut (Ref: Statuti, qershor, 2018. kreu II,) ku përcaktohet struktura organizative dhe



së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjëseve respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	përfaqësimi, bazë për ndërveprim midis Këshillit AFMM-së, Drejtorisë Administrative, Njesisë së Produksioneve dhe Këshillit Studentor.			
<b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.	Për realizimin e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni ka vendosur në vazhdimësi raporte bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit. Mund t'i referohemi këtu përgjigjes që na dhanë vetë drejtuesit e institucionit në lidhje me pyetjen konkrete si edhe dokumentacionit bashkangjitur, ku vihet në dukje marrëdhënia, bashkëpunimi me <i>Teatrin Kombëtar, Muzeun Kombëtar dhe Universitetin e Arteve</i> si edhe marrëdhënie bashkëpunimi me IAL-te jashtë Shqipërisë, në kuadër të përfshirjes si anëtarë të rrjetit të shkollave të filimit në botë CILECT, megjithatë mendojmë se institucioni, duhet të ketë një qasje më bashkëpunuese me insitucionet homologe në rrafshin kombëtar. (Ref: doc. 34- CILECT Full Members, MoU Stavrakos, IFS Köln, etj)			
<b>Kriteri 3.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	Njësia përgjegjëse për programin e studimit, Drejtoria Administrative, në bashkëpunim me Njësinë e Produksioneve, hartojnë raportin vjetor për MASR, ku renditen arritjet e vitit akademik, aktivitete, bashkëpunime të kryera, sipas udhëzimeve të MASR. (Ref: doc. 37-38 Raport vjetor, 2012- 2013; 2013-2014; 2014-2015; 2015-2016; 2016-2017 dhe 2017-2018)			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.	Institucioni ka vendosur marrëdhënie zyrtare dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ajo ofron, që më konkretisht janë shtëpi produksioni kinematografik në Shqipëri dhe të huaja. (Ref: Doc 34, Marrëveshje Kuvendi AFMM, 31 tetor 2018; Marrëveshje Stazhi dhe vlerësim 2017; Marrëveshje bashkëpunim MAMfondacion )			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Institucioni siguron në vijimësi trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit, ku përfshihen atelierë, masterclass si edhe synohen edhe trajnime profesionale afatshkurtra (Ref: doc. 34, Ftesë Florenc Papas EASTWEEK Script Writing Workshop for Neë Talents 2017, doc. 34-Masterclass and Workshop_2014-2019; doc. 34-OMSA Report Filmmaking Training 2019; dhe doc. 34-Open Call Docu Film Camp 2019 SHQ/ENG) në të cilët vihet në dukje se si AFMM paraqitet si institucion partner aktiv bashkë me studentët që përgatit, në aktivitetet si brenda vendit ashtu edhe jashtë tij.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
---	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	------------------------------



## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

### Standardi II.1

**Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit është organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Çdo vit akademik studenti ka mundësi të marrë minimalisht 60 ECTS. <i>(Statuti, Neni 20, 21; si edhe Rregullore e studimeve, Kreu V "Kontrolli i dijeve dhe provimet", Neni 18 "Kontrolli i dijeve" dhe Neni 19 "Vlerësimi i studentit", si dhe vërtetimi i notave i cili i dorëzohet çdo fund viti akademik secilit student doc.19-shembull vërtetim notash)</i>
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.	Programi i studimit të ciklit të parë synon formimin e shprehive të veçanta në specifikën e specialiteteve, format e punës mësimore janë leksionet, punët teorike dhe praktike, produksioni dhe realizimi i filmave, si dhe provimet. Vetë struktura mësimore e cila ka karakter teorik dhe praktik është e tillë që t'i përgjigjet formimit të studentit në shprehje të veçanta dhe në llojshmëri. <i>(Ref: Rregullore mësimore, kreu II, neni 5, struktura mësimore )</i> "Orët mësimore janë të ndara në "Përgatitje teorike", "Produksion", dhe "Punë kërkimore".
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuar në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Në vitin e parë raporti i orëve mësimore është 50% të orëve, produksion artistik dhe teori e praktikë specialitetesh dhe 50% të orëve, përgatitje teorike.</li> <li>• Në vitin e dytë raporti i orëve mësimore është 60% të orëve, produksion artistik dhe teori e praktikë specialitetesh dhe 40% të orëve, përgatitje teorike;</li> <li>• Në vitin e tretë raporti i orëve mësimore është 75% të orëve, orë produksion artistik dhe teori e praktikë specialitetesh dhe 25% të orëve, përgatitje teorike.</li> </ul>
<b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të parashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	<p>Pasi studenti ka kryer studimet e vitit të parë, keshilli pedagogjik duke vlerësuar aftësitë e studentit vendos profilin në të cilin do të vazhdojë në vitin e dytë dhe të tretë. Këshillit pedagogjik i lind e drejta në funksion të ecurisë së studentit në profilin e zgjedhur, në fund të vitit të dytë të rishikojë vazhdimësinë në vitin e tretë ose mundësinë e kalimit në një profil tjetër studimi."</p> <p>Kështu AFMM e ka organizuar programin e studimit në mënyrë të tillë që të ndihmojë në formimin qoftë nga ana teorike dhe zhvillimin nga ana individuale krijuese praktike të talentit dhe shpirtit të tij krijues duke e bërë të aftë të punojë me një ekip me pjesëtarë të tjerë të grupit studentor. AFMM aplikon për këtë sistemin e rotacionit kreativ, ku çdo student është i detyruar (mundësohet) të njohë edhe profile të tjera.</p>



	<p>(Ref:doc. 14. Përshkrimi i lëndëve)</p> <p>Po kështu programi i studimit për nga përmbajtja dhe organizmi u jep studentëve njohuri bashkëkohore mbi parimet bazë akademike, në sajë edhe të bashkëpunimit dhe përditësimit të praktikave më të përparuara të rrjetit të shkollave kinematografike në të cilat është anëtare. (Ref:doc. 5-13, Rregullorja_Tetor 2018, Kreu II Neni 5 "Struktura mësimore").</p> <p>Programet e studimit të ciklit të parë kultivojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike dhe profesionale.</p> <p>Nëse bëjmë një përshkrim të përmbajtjes, kurseve që programi i studimit ofron, vërejmë se në të ofrohen njohuri dhe kompetenca mbi skenarin, komponentët dhe diagramat dramaturgjike, personazhet, karakteret, regjinë, punën e saj me aktorët, mizanskenën, dekupazhin dramaturgjik dhe kompetenca të tjera teknike; mbi kameran, teknologjitë e herëshme (pelikul) dhe risitë teknologjike(numeriku), ndriçimin dhe makinerinë e kinematografisë. Mbi montazhin, linear (analog) dhe jolinear (numerik). ( Ref:doc. 14, Planet Mësimore, dhe 19-Syllabuset.)</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Programet përmbajnë të gjithë strukturën e parashikuar në ligjet kombëtare, por edhe konventat ndërkombëtare ku aderohet Shqipëria të cilat rregullojnë industrinë kinematografike dhe audiovizive si: Konventa e Bernës mbi Pronësinë Intelektuale dhe Konventën e Kombeve Europiane të Bashkëprodhimeve Kinematografike (Ref:ligj nr.10 037, datë 22.12.2008 për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Kombeve Europiane "Për Bashkëprodhimet Kinematografike")</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Programi i studimit ka përcaktuar qartë veprimtaritë formuese përmes grupimeve të lëndëve dhe moduleve, sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite, kjo, bazuar edhe në ekspertizën e shkollave simotra evropiane. Në strukturën dhe organizimin vihet re grupimi i kurrikulave dhe moduleve sipas sistemit rotativ (të përmendur më sipër), ku ndërkëmbehen postet teknike me ato krijuese në bazë departamentesh dhe e mbikëqyrur nga Njësia e Produksioneve. (Ref:dok. 14. Planet Mësimore, dhe dok. 19. Syllabuset)</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

**Standardi II.2**

**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Njësia kryesore, Akademia dhe departamentet: Departamenti i regjisë dhe skenarit, Departamenti i kameras dhe i montazhit dhe Njësia e produksioneve i përmbushin detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin, sipas statusit të veçantë (Ref: dok. 3, Statusi i Veçant_VKM 229 dt 26042018 për riorganizimin dhe dhënien e statusin e veçantë dhe Aneks 20-Marrëveshje MASR-</p>



	<p><i>AFMM personeli akademik Tetor 2018</i>). AFMM ka gjithsejt 12 studentë, ajo (<i>referuar statusit</i>) nuk detyrohet të ketë një numër të caktuar personel akademik të brendshëm si IAL-et e tjera. Aktualisht nga gjithsej 13 personel akademik, 4 janë personel akademik i brendshëm, ndërsa personeli akademik i jashtëm është 5, 4 janë të ftuar. (<i>Ref: Documentation from archive 7.Aneks/Shtojce Staf Akademik Viti 2019-2020, Akademia e Filmit dhe Multimedias Marubi</i>)</p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	<p>Duke qenë se AFMM funksionon si institucion me status të veçantë sipas (<i>dok.3-Statusi i Veçant_VKM 229 dt 26042018 për riorganizimin dhe dhënien e statusin e veçantë dhe dok. 20-Marrëveshje MASR-AFMM personeli akademik Tetor 2018</i>). Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, sipas Statutit, (<i>dok. 2 - Statuti AFMM 2018_MASR; neni 12, Struktura organizative</i>) është Njësia e produksioneve, drejtuesi i të cilës kryen funksionin e koordinatorit të programit të studimit dhe është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse, sipas Statusit të veçantë, <i>Njësia e produksioneve</i>, për programin e studimit të AFMM, i përbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike për kinematografinë, (<i>Ref: dok. 2- Statuti i AFMM2018_MASR dhe dok. 3-Statusi i Veçant_VKM 229 dt 26.04.2018 për riorganizimin dhe dhënien e statusin e veçantë dhe dok. 20-Marreveshje MASR-AFMM personeli akademik Tetor 2018, si dhe aneksat 20-22-CV staf akademik</i>).</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p>	<p>Po, Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përbush detyrimet për shkallën e kualifikimit të personelit akademik, specialist, sipas dokumentit të statusit të veçantë sipas të cilit akademia nuk i nënshtrohet kritereve të Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, qoftë nga pikëpamja e strukturës institucionale, organizimin akademik administrativ, kategoritë dhe titujt akademikë, diplomat dhe emërimet e tyre. (<i>Ref: dok 3-Statusi i Veçant_VKM 229 dt 26042018 për riorganizimin dhe dhënien e statusin e veçantë, pika 4, c dhe dok 20-Marrëveshje MASR-AFMM personeli akademik Tetor 2018, si dhe aneksat 20-22-CV staf akademik</i>).</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, Njësia e produksionit, sipas statusit të veçantë, i përbush plotësisht sipas parashikimeve ligjore për kinematografinë dhe sipas këtij statusi (<i>Ref: dok. 3-Statusi i Veçant_VKM 229 dt 26042018 për riorganizimin dhe dhënien e statusin e veçantë dhe dok 20-Marrëveshje MASR-AFMM personeli akademik;Tetor 2018, si dhe doc. 2b-Urdhër MASR për miratimin statutin 494 dt30.7.2018</i>)</p>			
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>



<b>Standardi II.3</b>	
<b>Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Njësia bazë, <i>Njësia e produksioneve</i> , i përmbush plotësisht sipas parashikimeve ligjore për kinematografinë dhe sipas statusit të veçantë, kriteret. Ajo ka informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit ( <i>Ref: dok. 3-Statusi i Veçant_VKM 229 dt 26042018 për riorganizmin dhe dhënien e statusin e veçantë dhe Doc. 19-Syllabuset</i> )
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	Programi i studimit është i organizuar në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Format e punës mësimore në të janë leksionet, punët teorike dhe praktike, produksioni dhe realizimi i filmave, si dhe provimet. Ky organizim është specifik dhe i përgjigjet kërkesës ligjore për kinematografinë dhe sipas statusit të veçantë ( <i>Ref: dok. 3-Statusi i Veçant_VKM 229 dt 26042018 për riorganizmin dhe dhënien e statusin e veçantë dhe doc. 19-Syllabuset</i> )
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara me kredite, sipas sistemit vendës dhe atij evropian, të ndara në vite e semestra. Këtu duhet të vëmë në dukje se vlerësimi në kredite dhe sidomos ndarja në semestra e vite paraqet një problematikë: programi i studimit, sipas profileve që përfshin është me nga 188, 188, 189, 186 ECTS. ( <i>Ref: 14-1-Planet mesimore 2013-2019 me ore dhe kreditet.pdf dhe 14-2-Plani mesimor sipas veprimtarive formuese.pdf</i> ) kjo vjen si pasojë edhe e organizimit të viteve, që në këtë pikëpamje kanë nga 60- 65 ECTS. Po kështu, vetë mënyra e llogaritjes së krediteve, në raport me numrin e orëve në total për lëndë mbetet e paqartë. Mendojmë se ky kriter është i përmbushur pjesërisht dhe rekomandojmë të rishikohet. ( <i>Ref: dok. 3-Statusi i Veçant_VKM 229 dt 26042018 për riorganizmin dhe dhënien e statusin e veçantë, doc. 19-Syllabuset, si dhe doc. 19-shembull vërtetim notash, doc. 15-Diplome me suplement dhe vërtetim notash</i> )
<b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.	Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihen informacionet të ndryshme për ngarkesën mësimore, orët e leksioneve dhe ato praktike, shtrirjen e lëndëve në semestra, ( <i>Ref: Doc. 10. 14b planet mesimore ne akreditim.pdf</i> ) po kështu, tek ( <i>Doc. 11.14a planet mesimore ne projekt.pdf</i> ) vihet në dukje edhe ngarkesa në orë brenda dhe jashtë auditorit, për çdo vit akademik. Shuma 930 orë për çdo vit akademik nuk është e mjaftueshme për të plotësuar numrin 60 të krediteve për vit. Prandaj sa më sipër kemi nënvizuar, përcaktimi i krediteve për lëndë mësimore si edhe organizimi në total i tyre duhen rishikuar me kujdes. Të njëjtën problematikë paraqet edhe



	plani mësimor (Ref: Doc. 14c Planet mesimore.pdf.) Sigurisht, në program dhe në rregulloren e programit shtjellohet qartë frekuentimi/ndjekja e programit dhe mënyra e vlerësimit të dijeve etj. (Ref:dok. 5-13- Rregullorja_Tetor 2018, Kreu II) Për arsytet e përmendura më lart, theksojmë se ky kriter përmbushet pjesërisht.			
<b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit. Sugjerojmë që për transferimet dhe ekuivalentimet e studimeve, dokumentacioni duhet të jetë më i plotë, konform të gjitha rregullave të mësipërme. (Ref:dok. 3-Statusi i Veçant_VKM 229 dt 26.04.2018 për riorganizimin dhe dhënien e statusin e veçantë si dhe në rregulloren, Neni 9 "Transferimet e studentëve" si edhe doc. 5-13-Rregullorja_Tetor 2018)			
<b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Programi i studimit duhet të përmbajë informacione bazë për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara. (Ref: dok. 5.13-Rregullorja Tetor 2018, dhe doc. 14-Planet Mësimore; doc. 14-Përshkrimi i Lëndeve AFMM; doc. 19-shembull vërtetimit notash dhe dok.19-Syllabuset)			
<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Përmbajtja e programit të studimit është në përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik, sipas një serie udhëzimesh në bazë të standardeve të mësimdhënies të CILECT dhe GEECT.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
		X		

#### Standardi II.4

**Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Ngarkesa e programit të studimit, me të gjitha specifikat e programit, detajimin e hollësishëm të realizimit të procesit mësimor, organizimit të tij me raportet e mirëmenduara mes teorisë dhe praktikës, paraqet problematikën e saj në lidhje me raportin staf i brendshëm dhe staf i jashtëm e i ftuar: 27% pedagogë të brendshëm e 73 % staf i jashtëm dhe i ftuar. Prej të cilëve 1 Prof. Dr. ,( i ftuar), 1 Prof. Asoc. ( i jashtëm), 1 PhD (e ftuar), 1 Dr. (i jashtëm), 2 Msc. (të jashtme) dhe 7 pa titull apo gradë studimesh akademike, por me një karrierë të pasur dhe personalitete në fushën e kinematografisë dhe audiovizionit, në



	<p>rang kombëtar dhe ndërkombëtar. “Kjo i ka garantuar institucionit tonë lidhjen mes shtëpive filmike, shesheve të xhirimeve dhe rrjeteve televizive kombëtare me qëllimin e përfitimit efikas të dijeve të studentit gjatë 3 viteve të studimit në AFMM.” (dok Shkresë Memo, Specialist i lartë në film dhe media me profil, Akademia e Filmit dhe Multimedias Marubi Të dhënat e tjera të marra nga: Aneks/Shtojce Stafit Akademik Viti 2019-2020, Akademia e Filmit dhe Multimedias Marubi) Po kështu për raportin teori praktikë shih: (Dok. 5-13-Rregullorja_Tetor 2018) raporti i organizimit teori/praktikë sipas viteve është: I: 70% me 30%; II: 50%-50%; III: 30%-70%.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i planit mësimor dhe takimi me studentët GVJ konstaton se lëndët janë të vlerësuara në kredite (ECTS) studenti në një vit akademik grumbullon jo më shumë se 60 ECTS, emërtimi i lëndëve u mundëson studentëve njohuritë dhe aftësitë e duhura për punësim. (Ref:Plani Mësimor)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe aftësimin profesional.</p>	<p>Lëndët,etydet dhe shpërndarja në vite e semestra, veçoritë që secila lëndë, paraqet në realizimin e produktin praktik, të vlerësueshëm në fund, mundësojnë arritjen e objektivave formuese të studentëve dhe kanë sjellë rezultate të të nxëniet dhe aftësimin profesional të studentëve. Kjo vërtetohet në mundësitë që u ofrohen për të bashkëpunuar në projekte e festivale. (Ref:dok. 53 Filmat e studentëve në festivalet si dhe të dhënat mbi ish studentët, dok. 17b- Alumnis fusha, dhe dok. 29-Të dhëna për punësimin e studentëve)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Rezulton se struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori -praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe i përshtatur mirë me programe të ngjashme ndërkombëtare, në ShBA dhe Europë. Ajo përditësohet sipas rekomandimeve dhe udhëzimeve të rrjetit të shkollave CILEECT dhe GEECT ku është antarësuar AFMM. (Ref:dok. 34-GEECT-Report-teaching-documentary, doc. 39-Admission courseëork and diploma assessment criteria geect konference)</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Veprimtaritë formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe atij praktik mundësojnë arritjen e objektivave, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim. Institucioni ka marrëveshje me universitetet në Itali, Gjermani dhe Francë. Ndërkohë edhe në RVB, theksohet se “...mobiliteti në drejtimin hyrës, nga universitetet në AFMM, në mungesë të shkollave apo programeve homologe të studimit në Shqipëri dhe rajon, si çdo shkollë anëtare e CILEECT është i kufizuar vetëm me shkollat homologe në Europë dhe SHBA”. (Ref:RVB, kriteri 5, standardi II,4).</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Programet e lëndëve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme, dhe kjo nxitet edhe nga aktivitetet e përbashkëta me rrjetin e shkollave kinematografike CILEECT dhe GEECT, si anëtare e tyre.(Ref: Doc. 80. 34-CILEECT Full Members.pdf)</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve,</p>




<p>programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>	<p>aftësive dhe kompetencave për programet e studimit. Siguria në këto garanci qëndron në ndërthurjen e vërtetë të teorisë me praktikën. Gjatë një viti akademik studentët garantojnë konkretizimin e dijeve teorike me produkte konkrete filmike apo audiovizuale.</p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës, brenda dhe jashtë vendit. Kjo vërtetohet qoftë me të dhënat për punësimet, si edhe pjesëmarrjen e studentëve në projekte e konkurse, në përballje me studentë të tjerë të rrjetit të shkollave CILECT. Po kështu duhet theksuar edhe fakti, se përmbajtja cilësore e programit mbështetet në përvojën e profesionistëve me profil të lartë të fushës, të cilët jo vetëm zhvillojnë cilësisht mësimdhënien, por edhe shërbejnë si kontakti kryesor i studentëve me tregun e punës. (Ref: <i>Të dhënat mbi aluminit, doc. 16. 17b-Alumnis_fusha.pdf</i>) dhe ftesat e ndryshme e pjesëmarrjet e studentëve në aktivitete të ndryshme ndërkombëtare. (Ref: <i>doc. 82. 34-FteseFlorenc Papas EASTËËËËË-Script Èriting Èorkshop for Neë Talents 2017.pdf</i>) apo të dhënat për stafin, veprimtarinë e tyre.</p>			
<p><b>Kriteri 9.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës, për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe përshtatjen sa më të mirë me kërkesat e tregut e punës. Njëkohësisht bëhet një përditësim i vazhdueshëm me risitë e shkollave të kinematografisë dhe televizionit, anëtarë të CILECT dhe GEECT, të cilat nga ana e tyre ndihmojnë jo vetë me informacionin dhe sugjerimet por edhe me pedagogë, specialistë të huaj, në periudha të shkurtra intensive mësimdhënieje. (Ref: <i>dok. 20-22-CV staf akademik, doc. 34- Masterclass and èorkshop_2014-2019</i>)</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi II.5</b>  <b>Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Për personelin akademik në kohë të plotë dhe të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit AFMM i përgjigjet dhe mbështetet në VKM 229 dt 26.04.2018 dhe marrëveshjen me Ministrinë e Arsimit. (Ref: <i>doc. 3-Statusi i Veçant_VKM 229 dt 26 04 2018, dhe doc. 20- Marrëveshje MASR-AFMM personeli akademik Tetor 2018</i>).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që</p>	<p>Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit, kanë nivelin e</p>



<p>pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit. Edhe në këtë kriter përgjigjet mbështeten dhe argumentohen në bazë të VKM 229 dt 26.04.2018 dhe marrëveshjes me Ministrinë e Arsimit. (Ref: doc. 3-Statusi i Veçant_VKM 229 dt 26 04 2018, dhe doc. 20- Marrëveshje MASR-AFMM personeli akademik Tetor 2018, si edhe doc. 23-24-25-26 – Të dhënat për personelin akademik 2013-2019)</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore dhe artistike e përgjithshme dhe specifika e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me natyrën dhe specifikën e moduleve të këtij programi studimi. Kjo si pasojë e zbatimit të VKM 229 dt 26.04.2018 dhe marrëveshjes me Ministrinë e Arsimit. (Ref: doc. 3-Statusi i Veçant_VKM 229 dt 26 04 2018, dhe doc. 20- Marrëveshje MASR-AFMM personeli akademik Tetor 2018)</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni, ka marrëveshje dhe bashkëpunon me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, dhe vë në dispozicion personelin e duhur e të kualifikuar dhe infrastrukturën, për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit. Duke shfrytëzuar këto marrëveshje AFMM ka organizuar shkëmbime studentësh, stafi akademik dhe bashkëpunime në prodhimin e filmave studentorë, të nderuar edhe me çmime në festivale ndërkombëtare të filmit studentor. (Ref:dok. Marrëveshje, dok. 34-FIOFA AFMM MoU 20170505, dok. 34-Marreveshjet Stazhi dhe vlerësim 2017, dok. 34-Marrveshje Bashkëpunim MAM fondacion, dok. 34-MoU IFS rënëal_2014, dok. 34-MoU_Stavrakos-Marubi2019, dok. 34-Open Call Docu Film Camp 2019 SHQ/ENG, dok. 33-invitation of ABDULLAHI Leutrim_Looking China 2018)</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Institucioni garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor dhe artistik për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore. Kjo realizohet nga AFMM dhe me mbështetjen e partnerëve shtetërorë ndërkombëtarë, që nga viti 2004 - vit i themelimit të AFMM-së. Kështu, institucioni garanton infrastrukturën kinematografike dhe televizive të të njëjtit standard me homologët e saj në Europë (Ref:dok. 42-Lista e pajisjeve, dok. 42- Ambjentet AFMM, dok. 42- AFMM tabelat për kapacitetet 2019- 2020-Godina, dok. 42- Raporti për kapacitetet pritëse nga MAS 2019)</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
---	------------------------------	-------------------------------------	------------------------------------	-------------------------------------





### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>				
<b>Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>				
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.	Institucioni ka hartuar udhëzues të posaçëm, rregulloren, për zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies (Ref: dok. 5-13- Rregullorja_Tetor 2018) “Ai zbaton strategjitë dhe metodologjitë e koordinuara të shkollave anëtare të CILECT dhe GEECT” (sipas RVB), (dok. 39-Admission courseëork and diploma assessment criteria Geect conference, si edhe dok. 34-GEECT-Reportteaching-documentary).			
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.	Strukturat përgjegjëse (Këshilli Akademik, Njësia Produksioneve dhe Këshilli Studentor) zhvillojnë monitorimin dhe vlerësojnë periodikisht aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik, mbi bazën e rezultateve të këtyre monitorimeve dhe vëzhgimeve ata bëjnë edhe vlerësime e sugjerime. (Ref:dok.5-13- Rregullorja_Tetor2018, për strukturën dhe funksionet e tyre ) po ashtu për vlerësimet me shkrim (dok. 54-shembull mbledhja KA 14 Janar 2019, dhe dok. 54-Vendim KA per profilet 2018)			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	Institucioni u jep mundësi studentëve, në fund të semestrit, të vlerësojnë me pyetësor on line (googledocs) duke i përfshirë ata në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë edhe mundësinë e trajtimit të ankimimeve. (Ref:dok. 40-Pyetësor 02/2019_Përgjigjet mbi lëndët_charts; dok. 40- Pyetësor studentor anonim, shkurt 2019; dok. 40- Pyetësor studentor anonim_charts)			
<b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Nga takimi që GVJ realizoi me përgjegjësen administrative u informua se struktura përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie i bën publike rezultatet e vlerësimit në këndin qendror të njoftimeve.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.	Institucioni, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies. Kjo mund të vërtetohet nga pjesëmarrja e përvitshme e pedagogëve, administratës në konferencat, kongreset dhe aktivitete të tjera të CILECT, në të cilat sigurisht marrin njohuri, ballafaqohen me praktika, fitojnë përvoja në drejtim të cilësisë së mëtejshme të mësimdhënies. (Ref:dok.43- GEECT_2011_Registration_Form_KujtimCashku; dok. 43-GEECT_2012_Conference-Elvis Hoxha; dok. 43-GEECT_2013_INVOICE_MARUBI_EolCASHKU; dok. 43-GEECT_2018-Teaching-documentary-Alfred Diebold)			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>



<b>Standardi III.2</b>	
<b>Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Institucioni ka organizuar mirë format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive përmes, lëndëve teorike dhe ushtrimeve, moduleve, si etydet dhe filmat studentorë, punëtorive (ëorkshope) për sektorë të veçantë të studimeve mbi kinematografinë dhe televizionin. (Ref: dok. 19-Syllabuset si edhe doc. 5-13- Rregullorja_Tetor 2018)
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.	Në një institucion ku studentët pranohen me konkurs, ku testohet në rradhë të parë prirja dhe talenti në fushën e kinematografisë dhe të televizionit (Ref: dok. 55- udhëzuesi për aplikim konkurs 2019), është e natyrshme që qysh në fillim zbulohen cilësi e prirje të cilat pastaj dora-dorës, do të vihen në pah gjatë procesit mësimor. Gjatë këtij procesi, aktiviteti formues krijues vihet në pah sidomos në sajë të një disipline në kërkim si edhe sidomos në sheshxhirim, ku studenti dalëngadalë vetëdijësohet për veçoritë e tij.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.	AFMM ka mbështetur personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike apo edhe në karrierën kinematografike, (stafi akademik, studentë) gjë që është kthyer një vlerë, sepse formimi apo suksesi në fushën profesionale u ka dhënë edhe një profil të lartë profesionisti në mësimdhënie. Duke i referuar, raporteve vjetore (Aneks/Shtojce Raport vjetor 2017-2018, Akademia e Filmit dhe Multimedias Marubi) nënvizojmë se "Pedagogu i dokumentarit, zoti A. D. morri pjesë në Konferencën e GEECT (Grupimi i Shkollave Europiane të Filmit dhe Televizionit) mbi mësimdhënien e filmit dokumentar që u mbajt në Bolzano të Italisë, nga 26-29 Prill 2018. Në datat 22-24 Maj 2018, Drejtori K. Ç, bashkë me një student të vitit të dytë, profili Montazh, u ftuan në Vjenë të Austrisë, nga Ministria e Jashtme e Austrisë, për të paraqitur projektin filmik Dealing ëith the Past, i cili u realizua një vit më parë. Shfaqja e 7 filmave të shkurtër për publikun e Vjenës, u pasua nga një bashkëbisedim, dhe sesion pyetje/përgjigje mes studentit, Drejtorit dhe audiencës." Në përputhje me VKM 229 dt 26.04.2018 dhe marrëveshjes me Ministrinë e Arsimit. (Ref. 3-Statusi i Veçant_VKM 229 dt 26042018, dhe doc. 20- Marrëveshje MASR-AFMM personeli akademik_Tetor 2018).
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe	Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie zbaton me kompetencë dhe përdor metoda bashkëkohore të mësimdhënies. (Ref: dok. 5-13- Rregullorja_Tetor 2018, Lista e Pedagoqeve 2015-2016; Lista e Pedagoqeve 2016-2017; Lista e pedagoqeve



përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.	2017-2018; (Lista e Pedagoqeve 2018-2019 ) duke qenë se në të shumtën e rasteve i përket personaliteteve me rëndësi të fushës dhe në kontakt me përvojat e huaja mbi kinematografinë, shpesh edhe mes lektorëve të huaj të përfshirë me përkushtim në mësimdhënie, ofron një përvojë ndryshe e më të përshtatshme me specifikat e mësimdhënies në shkolla të tilla me qendër artin si arkitektura dhe urbanologjia.			
<b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Personeli akademik përmirëson format e metodat e mësimdhënies duke reflektuar edhe mendimet e sugjerimet e studentëve, të cilët i paraqesin mendimet dhe sygjerimet e tyre përmes <i>Këshillit studentor</i> dhe pjesëmarrjes së përfaqësuesit të zgjedhur prej tyre çdo vit, në <i>Këshillin Akademik të AFMM</i> . (Ref:dok. 56-Vendim i <i>këshillit studentor në 2012</i> ; dhe dok. 56-Zgjedhja e <i>Kryetarit KStud2018</i> )			
<b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimi.	AFMM duke u bazuar dhe duke zbatuar me përpikmëri strategjitë dhe metodologjitë e koordinuara të shkollave anëtare të CILECT dhe GEECT, përdor metoda interaktive, duke e bërë kështu mësimin tërheqës dhe interaktiv. AFMM, gjithashtu ka garantuar me kualifikimin e saj, vazhdimin dhe thellimin e traditës së vyer të artit kinematografik shqiptar. Gjatë vitit akademik organizohen vizita e takime të ndryshme në muze, galeri artesh duke krijuar mundësinë e bashkëbisedimeve me personalitete e artistë të shquar. Këto vizita e takime kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në përgatitjen profesionale të studentëve. Ata krijojnë kontakte direkte me këto personalitete të cilët i janë përkushtuar mediave elektronike, publicitetit, multimedias dhe tendencave të tjera që lidhen me kulturën e imazhit, artit filmik, teatrit, pikturës, operas, baletit. (Ref:Raport vjetor i Akademisë së Filmit dhe Multimedias “Marubi”, Për Vitin Akademik 2017-2018 ).			
<b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	AFMM duke u bazuar dhe duke zbatuar me përpikmëri strategjitë dhe metodologjitë e koordinuara të shkollave anëtare të CILECT dhe GEECT, përdor metoda interaktive, të cilat nxisin, të menduarit krijues, të studentit. Për më tepër, “AFMM nxit frymën komunitare jo vetëm në mjedisin studentor e akademik, por dhe me grupet vulnerabël të shoqërisë.” Kështu janë nxitur takime me të rinj studentë nga Universitete të tjera si dhe nga gjimnazet e Tiranës duke trajtuar në to tematika e problematika shpesh herë të mbetura tabu. Filmat e studentëve të AFMM-së kanë trajtuar çështje të mprehta shoqërore si korrupsioni, krimi organizuar, trafikimi, intoleranca fetare dhe homofobia. (Ref:dok:4/24 Raport vjetor i Akademisë së Filmit dhe Multimedias “Marubi”, Për Vitin Akademik 2017-2018 ).			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b> <b>X</b>


### Standardi III.3

**Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin**



**profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>Institucioni ka krijuar mundësi optimale që procesi mësimor e shkencor të realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të këndshme estetikisht, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht. Mjedisi, qoftë jashtë, qoftë brenda është rikonstruktuar në 2004 me financim të UNESCO-s dhe mirëmbahet rregullisht. (Ref: dok. 42- AFMM tabelat për kapacitetet 2019-2020- Godina; dok. 42- Raporti për kapacitet pritëse nga MAS 2019 dhe dok. 42- Ambjentet AFMM, nr. 57-AFMM si ishte si është)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>	<p>Institucioni ka treguar kujdes të veçantë që ambientet e dedikuara për procesin mësimor të jenë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor. Anëtarësia në shkollat CILECT dhe GEECT ka ndikuar që t'i kushtohet po aq vëmendje ambientit për procesin mësimor sa edhe standardit të mësimdhënies. Pothuajse e gjithë infrastruktura teknike kinematografike dhe televizive e shkollës është dhuruar nga shteti Gjerman përmes Paktit të Stabilitetit. (Ref: dok. 42-Ambjentet AFMM, dhe dok. 42-Lista e pajisjeve)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>AFMM ka infrastrukturë dhe bazë materiale të plotë teknike kinematografike dhe televizive, analoge dhe numerike, të standardeve më të larta, sipas normave të shkollave më të mira të filmit në botë, anëtare të CILECT dhe GEECT. AFMM gjithashtu ka infrastrukturë të plotë informatike në përdorim të studentëve në ambientet e bibliotekës, mediatekës dhe arkivës filmike të shkollës. Institucioni i përgjigjet në mënyrë të vazhdueshme personelit akademik dhe studentëve që të shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar, IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor. (Ref: Takimet gjatë vizitës në AFMM)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni ka krijuar të gjitha mundësitë që literatura bazë dhe ndihmëse, e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), të garantojë marrjen e dijeve dhe të njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit. "Biblioteka profesionale e Akademisë Marubi, donacion i Kooperacionit Zvicerian në Shqipëri, por edhe i disa kineastëve shqiptarë dhe të huaj, përmban më tepër se 5000 tituj librash në shqip, italisht, frengjisht dhe gjermanisht. Bilioteka pasurohet çdo vit dhe me donacione të shtëpive botuese." Po kështu, mediateka e AFMM ka 3000 filma dokumentarë dhe fikson të metrazheve të ndryshme nga kinematografia shqiptare dhe ajo botërore në përdorim të studentëve. Arkivi Filmik i AFMM ka të depozituara të gjitha filmat, etydet dhe ushtrimet e xhiruara nga studentët e shkollës në 15 vite aktivitet të Akademisë së Filmit dhe Multimedias Marubi, në total më shumë se 1000 orë materiale arkivore (Ref: Të dhëna nga RVB dhe gjatë vizitës, dok. 45-BookPedia_snapshot)</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e</p>	<p>AFMM, ka edhe një videotekë të pasur me mbi 3000 tituj filmash</p>





<p>institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>nga klasikë të viteve 1900 pa zë, si edhe nga produksionet e fundit, sjellë nga Akademia Europiane e Filmit dhe CILECT. (Ref:Të dhëna nga vizita në IAL dhe të tjera nga RVB, dok. 45- DVD Pedia snapshot).</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Për këtë AFMM ka një sallë informatike me kompjutera dhe rrjet, që u siguron studentëve dhe personelit akse të gjithmonshëm në biblioteka. Kështu, studentët dhe personeli kanë mundësi të aksesojnë on line, materiale që pasurojnë formimin e tyre profesional. (Ref:dok 42-Ambjentet AFMM)</p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Nga vizita ne ambjentet e AFMM GVJ konstaton se infrastruktura laboratorike e institucionit, që vlen për të realizuar detyrat e kursit, punimet e diplomave është në funksion të studentëve, realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët. Vlen të theksohet vënia në funksion e kësaj infrastrukture edhe për ish-studentët dhe bashkëpunëtorët e produksioneve artistike që kanë impakt me këtë institucion.</p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Personeli akademik i institucionit nuk përdor platforma on-line (e-learning). Në vend të tyre AFMM ka organizuar dhe organizon rregullisht masterklas me personalitete të shquar të kinematografisë botërore. E-learning nuk përdoret për programin e studimit kinematografik nga shkollat e CILECT. (Ref:dok. 34 Masterclass and ëorkshop 2014-2019)</p>			
<p><b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.</p>	<p>AFMM, ka krijuar kushtet që personeli akademik dhe studentët të shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm të institucionit. Ata kanë adresa emaili (<i>afmm.edu.al</i>) të personalizuar, nëpërmjet të cilave studentëve u vjen informacioni i nevojshëm mësimor. Ka raste kur në vend të emailit përdoret GoogleForms, sidomos në sondazhe, pyetësor etj. Po kështu në ndihmë të një komunikimi sa më të ngushtë dhe të menjëhershëm mes studentëve dhe pedagogëve përdoren platformat Facebook dhe Ëhats APP.</p>			
<p><b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p>	<p>AFMM, ka një numër të vogël studentësh dhe rrjedhimisht edhe puna me to është individuale. Studentët asistohen dhe orientohen nga stafi akademik gjatë të gjithë procesit të studimit të tyre, në realizimin e produksioneve, etydeve, filmave, ideve të tyre krijuese. "Filmi studentor është treguesi kryesor i evoluimit, kualifikimit dhe diagramës së ecurisë së një studenti." Personeli akademik i institucionit orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, apo në produksionin e një filmi, si edhe asiston dhe mbështet zhvillimin dhe vënien në punë të ideve krijuese. (Ref: doc. 4. 14-5-Memo.pdf).</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>



<b>Standardi III.4</b>	
<b>Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirëimit të cilësisë së mësimdhënies.	Në kuadër të përmirëimit të cilësisë së mësimdhënies, institucioni ka organizuar në vijimësi shkëmbim përvoja me institucionet simotra pjesë e CILECT, prej të cilit shkëmben dhe merr përvojat më të mira (Ref: Doc. 4. 14-5-Memo.pdf) si edhe ka një strukturë të përhershme që merret me përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, Këshillin Akademik (Ref:dok. 2-Statuti AFMM 2018_MASR.)
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.	Vemë re se njësitë bazë, Departamenti i Regjisë dhe Skenarit, Departament i Kameras dhe Montazhit, Njësia e Produksioneve ndjekin me vëmendje dhe janë përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjen e vetëdijes të personelit akademik dhe studentëve për cilësinë në programet e studimit që ofron institucioni.(Ref: dok. 2-Statuti AFMM 2018_MASR. dhe doc. 5. 23-Tëdhënat për njësinë bazë dhe departamentet 2013-2019.pdf)
<b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.	AFMM si pjesë përbërëse e rrjetit të CILECT, në plane mësimore përfshin programe shkollash filmi dhe TV, nga më të mirat ndërkombëtare. Bashkëpunimi mes trupave pedagogjike dhe studentëve shqiptarë dhe të huaj të cilat krijojnë mundësi të reja praktikash, metodologjish dhe kurrikulash profesionale është një nga pikat ku duhet vlerësuar AFMM. Në këto plane mësimore të AFMM-së përfshihen, vendas dhe të huaj të cilët i sjellin studentëve një nxitje dhe frymë ndërvepruese. Fusha e dijes është e hapur, konkurruese e krahasuese si për nga metodat ashtu dhe nga pasuria e këndvështrimeve nga më të ndryshmet. (Ref: Documentation from archive 5. Shkresë Memo, Specialist i lartë në film dhe media me profil, Akademia e Filmit dhe Multimedias Marubi), AFMM zbaton rigorozisht metodologjitë e shkollave anëtare të CILECT dhe GEECT.
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Ka përpjekje nga ana e personelit akademik dhe atij mbështetës në drejtim të kualifikimit dhe kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Këtu mund të përmenden jo vetëm pjesëmarrjet direkte në veprimtari shkencore ose aktivitete kinematografike, por edhe pjesëmarrja e studentëve bashkë me pedagogë në konkurse apo aktivitete artistike e krijuese. “Realizim i filmave dhe programeve në bashkëpunim me studentë të shkollave homologe janë një eksperiencë me mjaft interes. E materializuar në vite e me mjaft rezultate duke përfshirë dhe çmime e vlerësime morale por edhe financiare, në këto festivale ndërkombëtare ku përfaqësojnë kulturën Shqiptare.” (Ref: Documentatation from archive 5. Shkresë Memo, Specialist i lartë në film dhe media me profil, Akademia e Filmit dhe Multimedias Marubi), Personeli akademik ka një



	përvojë shkollimi europian, apo ka një aktivitet të spikatur në kinematografi dhe si i tillë sjell në mësimdhënie përvojën e një ballafaqimi të tillë. (Ref: CV- të e Personelit Akademik ) Apo edhe përvoja e sjellë nga personeli akademik i ftuar. (Ref: personeli akademik i ftuar ndër vite) Ka shembuj të formimit të personelit në shkolla dhe institucione të njohura të filmit në Europë dhe më gjerë.			
<b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	Strukturat dhe njësitë përgjegjëse të institucionit, duhet të trajnojnë më shumë personelin akademik (stafin e ri) për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.			
<b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	Përgjegjësia ndaj zbatimit të programit të studimit si edhe përmirësimin të tij nga ana e drejtuesve të institucionit dhe stafit të tij shprehet qartë, qoftë në rregulloren e AFMM-së, qoftë në Statusin e AFMM-së. (Ref:dok. 2-Statuti AFMM 2018_MASR.pdf dhe 5-13-Rregullorja_Tetor 2018.) Ndjenja e përgjegjësisë nga ana e personelit akademik dhe personelit ndihmës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhimin për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja mendojmë se përbën një problem që duhet trajtuar në vijimësi.			
<b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	Vlerësojmë se personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse të institucionit. (Ref: Documentation from arshive 5. Shkresë Memo, Specialist i lartë në film dhe media me profil, Akademia e Filmit dhe Multimedias Marubi).			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi III.5</b>	
<b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Institucioni përcakton me rregullore të posaçme kriteret dhe mënyrat e testimit të vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, të cilat publikohen dhe njihen nga studentët. Duke qenë shkollë me status të veçantë, rregullorja dhe statuti i AFMM, përfshijnë një kapitull të veçantë mbi vlerësimin e njohurive. (Ref:dok. 5-13-Rregullorja_Tetor 2018.pdf, Kreu V)
<b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në	Studentëve, në fillim të çdo lëndë informohen mbi metodologjinë e testimit dhe të vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve nga titullari i lëndës. (E dhënë e marrë nga vizita në institucion, biseda me studentët si edhe me stafin akademik)




syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.									
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Përmes formave dhe mënyrave të ndryshme, institucioni realizon testimin e vlerësimin e njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të studentëve, duke mundësuar demonstrimin e njohurive dhe kompetencave të fituara. Vlerësimi realizohet përmes provimeve semestrale, kontrolleve dhe pjesëmarrjes në orët mësimore. (Ref: dok. 5-13-Rregullorja_Tetor 2018. Kreu V, neni 18, 19)								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<b>Standardi III.6</b>	
<b>Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.	Provimet teorike janë semestrale. Kontrollet e dijeve dhe aftësive profesionale zhvillohen në vijimësi gjatë gjithë vitit akademik. (Ref:dok. 5-13-Rregullorja_Tetor 2018. )
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminonjë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Për të rritur transparencën dhe shmangur format e abuzimit, në funksion të testimit dhe vlerësimit, AFMM vë në zbatim sisteme elektronike(Google Forms Anonim).Vlen të përmendet që kjo është mundësuar nga kërkesa e vetë stafit akademik. (Ref:dok. 5-13-Rregullorja_Tetor 2018. )
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	Vlen të përmendet përballja publike e detyrimeve semestrale dhe vjetore të studentëve edhe me specialistë të ftuar të fushës përkatëse. (Ref:dok. nr.61-Dosjet nga studentet-Filmat e fundvitit afishimet)
<b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.	AFMM, si IAL me status të veçantë, nuk aplikon testimin me shkrim ( kjo është e shprehur edhe në Aneksin nr. 3_Status I veçantë_VKM 229 dt.26042018, nr. 59-PV_Vlerësim FV_VI).
<b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënësit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Konstatuar nga vizita ne institucion si edhe referuar Aneks nr. 59-PV Vlerësim FV-VI, për të përmirësuar procesin formues të studentëve, vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet me komente/feedback, si edhe debate të hapura.
<b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli	Nga takimet ne insitucion GVJ u informua se njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik i institucionit nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra. Vlen të përmendet fakti i aplikimit të deklaratës jo plagjiaturë nga vetë studenti.



akademik.				
<b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Projekti konkret artistik është dokument i evidentueshëm dhe njëkohësisht i arkivuar për çdonjërin nga studentet. Vlerësimi behet nga grup pedagogesh bazuar ne statutin dhe rregulloren e AFMM. (Ref: Kalendarit te miratuar nga Këshilli Akademik).			
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Referuar <i>Rregullores_Tetor 2018</i> . dhe <i>Statutit</i> te AFMM, gjithçka realizohet sikundër edhe në shkollat homologe me AFMM-në, anëtare të rrjetit CILECT.			
<b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	Referuar <i>Aneks nr. 62_Kërkesë nga studentët</i> , si edhe kontaktit tonë fizik me grupet studentore, vlerësojmë se çdo kërkesë e studentëve gjen vëmendjen përkatëse.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi III.7</b>	
<b>Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët,duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Produksioni artistik është kusht kategorik për çdo student. Struktura e programeve mësimore plotëson kushtin e kultivimit te dijeve nga studentet dhe gjithë formimit artistik profesional te tyre.(Ref: dok nr. 61_Dosjet nga studentët- Filmata e fundvitit afishimet)
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Duke përdorur si një nga kriteret e pranimit gjuhën e huaj (Anglisht, Italisht dhe Frëngjisht), programi i studimit i realizuar ne dy gjuhe, siguron kultivimin e aftësive specifike profesionale te studenteve .
<b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	Referuar <i>aneks nr. 64 shembuj pyetjet provimet me shkrim_2019</i> , Vetë modeli i vlerësimit që përdoret ne AFMM jep mundësi kontrolli dhe analize mbi dijet e fituara nga studenti. Analizat janë semestrale dhe vjetore.
<b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.	Referuar <i>Rregullores_Tetor 2018</i> si edhe <i>aneksit nr. 64 shembujt pyetjet provimet me shkrim, 2019</i> , AFMM përmes raporteve dhe analizave me shkrim, duke operuar me mendim kolegjal, pas çdo përfundimi lënde dhe moduli, trajton çështjet e rëndësishme dhe orienton studentët në implementimin e mëtejshëm.
<b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik	Personeli akademik i ka kushtuar vëmendje të veçantë orëve të






realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	hapura dhe seminareve mbi zhvillimet e reja të shkencës dhe teknologjisë filmike, jashtë strukturës së programit të studimit. Organizimi i punishteve për problematika të caktuara përbën një rast që vlen si përvojë pune me interes të veçantë. (Ref:dok nr.65_shembull orari javor i afishuar).			
<b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	Shembulli i Atelieve të së premtës ku materializohen njohuritë teorike përmes shkrimit, xhirimit dhe montimit të një skene filmike për 24 orë dëshmon realizimin në mase të konsiderueshme për çdo student të shpalesjes së njohurive të fituara.			
<b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.	Nga vizita në institucion dhe bashkëbisedimi me stafin pedagogjik, vlerësojmë se Këshilli Akademik dhe Njësia e Produksionit organizojnë punën në grup për çdonjërin nga realizimet e projekteve të studentëve.			
<b>Kriteri 8.</b> Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.	Referuar <i>Aneksit nr. 61-Dosjet nga stud-Filmat e fundvitet afishimet, nr. 60 – Dorëzim i punës teorike 2019</i> si edhe bazuar në <i>statutin dhe rregulloren e AFMM</i> , vlerësojmë se personeli akademik i institucionit krijon kushte optimale për të elaboruar dhe nxitur kreativitetin dhe kërkimin e mëtejshëm shkencor.			
<b>Kriteri 9.</b> Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.	AFMM mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet materialisht studentët. Ndjeshmëria e qeverisë shqiptare për përgjysmimin e tarifës së studimit i mundëson institucionit standardin me shkollat homologe. (Ref:dok nr. 66 –FZ-2019-VKM,571).			
<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Për të rritur mobilitetin e studentëve, personeli akademik ka mundësuar forma të mësimdhënies edhe me institucione bashkëpunuese. (Kujtojmë shfrytëzimin e përfshirjes së AFMM në rrjetin CILECT dhe GEECT të shkollave filmike)			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.8</b>	
<b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Institucioni ka hartuar procedura të posaçme për provimin final / mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë përmes përballjes publike. Mbrojtja e diplomës bëhet me shkrim dhe me gojë dhe me analizë vlerësuese nga një komision profesional për çdo film të fundvitet si edhe për filmin e mbrojtjes së diplomës. (Ref:dok. nr. 60 – Dorëzim i punës teorike 2019, dhe nr. 58 – Lajmërim calendar FV 2019).
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione,	Referuar <i>Aneksit nr. 61 – Dosjet nga stud- Filmat e fundvitet afishimet dhe nr. 60- Dorëzimi i punës teorike 2019</i> , konstatojmë se, strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik i



udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	institucionit, në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës, asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe mbi të gjitha materialet e nevojshme.			
<b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Referuar <i>Aneksit nr. 67 – Vlerësim Komisioni Punë Teorike 2018</i> , konstatojmë se, komisioni i provimit përbëhet prej 3 anëtarësh, njëri domosdoshmërisht përfaqësues i agjencive shtetërore të ngarkuara për organizimin kinematografik.			
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.	Referuar <i>Aneksit nr.61 – Dosjet nga stud- Filmat e fundvitit afishimet dhe nr. 60- Dorëzimi i punës teorike 2019</i> , vlerësojmë se për çdo projekt dhe detyre të studentit deri tek realizimi i diplomës, personeli akademik asiston dhe ndjek procesin.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	AFMM siguron logjistikë të plotë produksioni dhe post-produksioni filmik për çdo student në mbrojtjen e diplomës. Konstatuam se infrastruktura e instaluar në mjediset e AFMM është e admirueshme për një shkollë profesionale.			
<b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Referuar <i>Aneksit nr. 61 – Dosjet nga studentët- Filmat e fundvitit afishimet</i> , Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në shkrimin e temës si edhe realizimin e projektit artistik i cili mishëron mbrojtjen e diplomës para komisionit.			
<b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studentit vlerësohet me notë.	Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studentit vlerësohet me note dhe kreditet përkatëse që i përgjigjen realizimit të filmit të diplomës.			
<b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studentit pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Referuar <i>Aneksit nr. 15 – Diplomë me suplement dhe vërtetim notash, dhe nr. 15 b – Shkresë MAS Number id diploma</i> , Suplementi i diplomës ofrohet në Anglisht dhe Shqip.			
<b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Referuar <i>Aneks nr. 15 – Diplomë me suplement dhe vërtetim notash, dhe nr. 15 b – Shkresë MAS Number id diploma</i> . Cdo student pajiset me dokumentacionin përkatës sipas 4 profileve të studimit që ofron AFMM.			
<b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.	Institucioni arkivon e ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen. Kopjet e filmave të realizuar nga studentët dhe dokumentacioni përkatës bëhen pjesë e Arkivit Qendror Shtetëror të Filmit. Një kopje i ofrohet edhe vetë studentit. (Ref: Takimit me studentët)			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>





Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.	Referuar Anekseve nr. 23-24-25-26- Të dhënat për personelin akademik 2013-2019, nr. 23- Të dhënat për njësinë bazë dhe departamentet 2018-2019, nr. 44 –Formati i dosjes pedagogët, nr. 44- Formati i dosjes staf me kohë të plotë, vlerësojmë se AFMM plotëson këtë kriter.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.	Referuar Aneksit nr. 2 – Statuti AFMM 2018_MASR, Neni 3, Procedura 3 dhe nr. 5-13-Rregullorja _Tetor 2018, si edhe RVB, S. IV, kr. 2, vlerësojmë se duke qene se aplikimet për rekrutimin e personelit realizohen përmes portalit e-albania, procedurat dhe kriteret janë transparente për të interesuarit. Në mbështetje të këtij mendimi tonë, sjellim në vëmendje edhe takimin e bërë me Përgjegjësen Administrative, ku u theksua: “Në radhë të parë bëjmë deklarinimin e postit vakant, pastaj e kemi të thjeshtë, sepse jemi në kontakt me profesionistët” (Ref: Takimet gjatë vizitës.pdf)
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton procedura e kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.	Referuar Aneks nr. 2 Statuti AFMM 2018_MASR, dhe nr. 5-13-Rregullorja _Tetor 2018, procedurat dhe kriteret e rekrutimit vlerësojmë se janë transparente.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të	Sipas modulit përkatës, shpallet konkursi me kriteret që përputhen me programin e studimit. Kandidati përzgjidhet mbi bazën e dosjes. Shembull konkret pedagoge B.Y Pedagoge e Analizës së Filmit dhe Historisë së Filmit, vjen pas studimeve në Marubi dhe të dy Masterave (1. Teori dhe Estetike Filmi, France; 2. Politika Kulturore dhe Menaxhim Arti, Beograd) Referuar Aneksit nr. 3-Statusi i veçantë-VKM 229 dt. 26.04.2018.



studimit.				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi IV.2</b>				
<b>Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive</b>				
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësi të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	Vlerësojmë se ambientet dhe kushtet që ofron AFMM përputhen më së miri për realizimin e procesit mësimor. Për këtë i referohemi (doc. 109 42-AFMM tabelat për kapacitetet 2019-2020-Godina.pdf; doc. 110. 42-Ambjentet AFMM.pdf; doc. 111, 42-Lista e pajisjeve.pdf) si edhe raportit për kapacitetet pritëse të institucionit nga MAS. Doc. 112.42-Raporti per kapacitet pritese nga MAS 2019.pdf, )			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	AFMM ka shembuj konkretë të angazhimit të tij në formime profesionale të stafit akademik në institucione dhe shkolla të njohura të rrjetit CILECT dhe GEECT. (Ref: Aneks nr. 43-GEECT 2011 Registration Form Kujtim Çashku, 43-GEECT 2012 Conference Elvis Hoxha, 43-GEECT 2013 INVOICE MARUBI Eol Çashku etj).			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	Referuar Aneks nr. 34- Masterclass and ëorkshop_2014-2019, theksojmë bashkëpunimet me industrinë kinematografike europiane te shkollave te rrjetit CILECT dhe GEECT, si edhe FujiFilm, ARRI, Blackmagic, JVC, etj.			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.	Referuar Aneksit nr.34- Masterclass and ëorkshop_2014-2019 , vlerësojmë se institucioni ka dëshmuar angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë. AFMM ka personel akademik prej 13 pedagogësh vendas dhe të ftuar nga jashtë.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi IV.3</b>				
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit</b>				
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të	Referuar Aneksit nr. 42-Raporti për kapacitetet pritëse nga MAS 2019, nr. 57- AFMM si ishte si është, nr. 73-Planimetria brenda dhe jashtë, vlerësojmë se ambientet dhe kondicionet që ofron AFMM përputhen më së miri për realizimin e procesit			



numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	mësimor.			
<b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Referuar <i>Aneksit nr. 42-Raporti për kapacitetet pritëse nga MAS 2019, nr. 57- AFMM si ishte si është, nr. 73-Planimetria brenda dhe jashtë</i> , vlerësojmë se AFMM përmbush standardet për mjedis dhe infrastrukture, si edhe për personel akademik profesional të saj.			
<b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Referuar <i>Aneksit nr. 42-Raporti për kapacitetet pritëse nga MAS 2019, nr. 57- AFMM si ishte si është, nr. 73-Planimetria brenda dhe jashtë</i> , vlerësojmë se AFMM me mjediset me një strukturë prej 3906.5 m <sup>2</sup> në shërbim të programeve të studimit që ofrohen, me ambiente teorie, laboratorë, studio produksioni, praktikash, laborator fotografik, studio montazhi, njësi regjistrimi me zë, sallë grimi, gardërobë, ambiente xhirimi, sallë kinemaje, sallë studimi, bibliotekë, videotekë etj të mirëpajisura për të realizuar plotësimin e kërkesave të programit.			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.	Referuar <i>Aneksit nr. 74 –Kompjuterat AFMM në 2019</i> , infrastrukture teknike, kinematografike dhe televizive përmbush kriteret ndoshta edhe për një sipërmarrje filmike model.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.	Referuar <i>Aneksit nr. 42-Raporti për kapacitetet pritëse nga MAS 2019, nr. 57- AFMM si ishte si është, nr. 73-Planimetria brenda dhe jashtë</i> , vlerësojmë se AFMM përmbush standardet për mjedis dhe infrastrukture për zhvillimin e praktikave profesionale, si edhe për personel akademik profesional të saj.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi IV.4

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të	Referuar <i>Aneksit nr. 45-BookPedia_snapshot, 45-DVDPedia_snapshot</i> , si edhe nga vizita gjatë së cilës u vizituan bibliotekadhe videoteka që mund të vlerësohen për fondin e pasur dhe ambientet e përshtatshme që u ofrohen studentëve për



barabartë nga studentët e programit të studimit.	të lexuar apo studiuar, mendojmë se AFMM përmbush më së miri këtë kriter.								
<b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikes së programit të studimit.	Referuar <i>Aneksit nr. 45-BookPedia snapshot, 45-DVD Pedia snapshot</i> dhe vizitës në institucion, biblioteka, mediateka dhe videoteka gëzojnë standarde bashkëkohore. Veçojmë vlerën e veçante që ka organizimi i shfaqjeve filmike me shtrirje gjithëvjetore.								
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.	Referuar <i>Aneksit nr. 75 – Screenings Public activities_2017-2018, nr. 76-prog filmave 2004-2015 për studentet dhe nr. 77-AFMM Events 2016-2019, si dhe doc. 2 B-Marreveshje venie dispozicion pajisje_ish studentet_model.pdf</i> , vlerësojmë se institucioni u ka krijuar kushte të barabarta studentëve për të pasur akses në bibliotekë, për t'iu përgjigjur kështu përgatitjes së tyre në lidhje me programin e studimit.								
<b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Referuar <i>Aneksit nr. 45-BookPedia snapshot, 45-DVDPedia snapshot</i> dhe vizitës në institucion vlerësojmë se institucioni ka jo vetëm një bibliotekë të pasur që i përgjigjet më së miri literaturës për programin e studimit që ofron, por edhe këto janë vendosur në ambiente të përshtatshme me kënde leximi dhe shfrytëzimi të materialit audiovizual për studim.								
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	Referuar <i>Aneksit nr. 45-BookPedia snapshot, 45-DVDPedia snapshot</i> , dhe vizitës në institucion vlerësojmë se AFMM i akordon një pjesë të fondit të saj përditësimit të literaturës dhe teknologjisë koherente.								
<b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Referuar <i>Aneksit 5-13-Rregullorja_Tetor 2018</i> , si edhe bashkëbisedimit me studentët, Biblioteka, videoteka dhe mediateka janë vënë në dispozicion të studentëve për 24 orë.								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

#### Standardi IV.5

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit**

#### Kriteret

#### Vlerësimi i ekspertëve

**Kriteri 1.** Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë

Referuar *Aneksit nr. 78-Statistikat nr. Studentëve 2004-2018, nr. 79-Diploma arkivi 2004-2018*, vlerësojmë se administrata dhe zyrat përkatëse janë në funksion të informimit permanent të




informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	studentëve.			
<b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Institucioni nuk disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit.			
<b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Institucioni nuk disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit.			
<b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Institucioni nuk disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit.			
<b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Institucioni nuk disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit.			
<b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Referuar <i>Aneksit nr. 47a-Faqja Web AFMM-Admission, 47b-AFMM The Faculty, 47c-Faqja Web AFMM Program</i> , në faqen web disponohet informacioni në gjuhën shqipe dhe atë angleze, nga shpallja e fituesve të konkursit e deri tek diplomimi.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
		X		

#### Standardi IV.6

**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Referuar <i>Aneks nr. 37 38- Raportet Vjetore 2012-2018</i> , AFMM ka hartuar një raport financiar të kostove të programeve të studimit dhe plan për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. Statusi i veçantë i mundëson këtij institucioni subvencionin për tarifat e studentëve si edhe për realizimin e





	detyrimeve semestrale dhe vjetore të studentëve në procesin materializues-artistik.			
<b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.	Referuar <i>Aneks nr. 49 Raporti Financiar që lidhet me kosto program dhe nr. 50 – plani i financimit</i> , planifikimi financiar mbulon të gjitha zërat që kanë të bëjnë me koston e programit dhe aktiviteteve mbështetëse për realizimin e të katër programeve të studimit që ofron ky institucion. Nga bashkëbisedimi me drejtuesit e institucionit, mësuam se 50% e financimit vjetor për këtë shkollë mundësohet nga Buxheti i Shtetit. Kjo është një garanci më tepër për funksionimin normal të AFMM. Referohemi gjithashtu <i>Aneks nr.66-FZ-2019-VKM 571</i> .			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.	Nga <i>Aneks nr. 49- Raporti financiar që lidhet me koston e programit dhe nr. 50-plani i financimit</i> , si dhe shqyrtim joprofesional i pasqyrave financiare vjetore, vërehet se shpërndarja e buxhetit është e demonstruar në mënyrë të detajuar. Institucioni i është nënshtruar monitorimit nga MASR si edhe nga KLSH në vijimësi dhe rezulton pa problematika.			
<b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	Referuar <i>aneksit nr. 49- Raporti financiar që lidhet me koston e programit dhe nr. 50-plani i financimit</i> , si dhe shqyrtim joprofesional i pasqyrave financiare vjetore, vërehet se shpërndarja e buxhetit është e demonstruar në mënyrë të detajuar. Referuar gjithashtu <i>Aneksit nr.66-FZ-2019-VKM 571</i> .			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.	Referuar <i>aneksit nr. 49- Raporti financiar që lidhet me koston e programit dhe nr. 50-plani i financimit, aneks nr.66-FZ-2019-VKM 571</i> , si dhe nga bashkëbisedimi me drejtuesit e institucionit, mësuam se 50% e financimit vjetor për këtë shkollë mundësohet nga Buxheti i Shtetit. Kjo është një garanci më tepër për funksionimin normal të AFMM.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së</b>	<b>Nuk</b>	<b>Përmbushet</b>	<b>Përmbushet</b>	<b>Përmbushet</b>
---------------------------------	------------	-------------------	-------------------	-------------------





standardeve të fushës IV	përbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
			X	

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</b></p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Referuar <i>Aneks nr. 2 Statuti AFMM 2018-MASR, nr. 2b-Urdhër MASR për miratimin statutin 494 dt. 30.07.2018, 3- Statusi I Veçante VKM 229 dt. 26.04.2018, 5- 13-Rregullorja Tetor2018, nr. 54 KA- vendim kriteret e pranimit, nr. 54-KA vendim miratim tarifit</i>, institucioni zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi, aktet e veta rregullatore si edhe me aktet ligjore e nënligjore, direktivat, rekomandimet dhe strategjitë e edukimit kinematografik të CILECT dhe GEECT..</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Referuar <i>Aneks nr. 2-Statuti i AFMM 2018_MASR, 5-13-Rregullorja Tetor 2018, nr. 54-KA vendim kriteret e pranimit</i>, te gjitha procedurat janë transparente dhe publike për të gjithë kandidatet.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Referuar <i>Aneks nr. 47a- Faqja ëeb AFMM-Admission</i>, jemi të mendimit se duhet të punohet më hollësisht që kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit të jenë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga të interesuarit.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Referuar <i>Aneks nr. 54-KA vendim kriteret e pranimit</i>, AFMM operon me kriter konkursin e pranimit.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Referuar <i>Aneks nr. 54-KA vendim kriteret e pranimit</i>, vlerësojmë se këto kriteret janë në përputhje me Ligjin dhe aktet nënligjore të arsimit të lartë, si edhe me ligjin e kinematografisë dhe të pronësisë intelektuale.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të</p>	<p>Referohemi <i>Aneks nr. 55- Udhëzuesi për aplikim konkursi 2019</i> vlerësojmë se në AFMM çdo kandidat ka mundësinë e</p>




interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	informimit për procedurat dhe kriteret e pranimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

**Standardi V.2**  
**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Referuar <i>Aneksit nr.5-13- Rregullorja Tetor 2018, nr. 80-Orari java e parë 2018-2019</i> , institucioni disponon informacionin e plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Gjithçka realizohet përmes sesioneve informuese në grup si edhe sesioneve individuale kur ka kërkesë nga studenti.			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Referuar takimit me studentet, vlerësojmë se ata kanë informacionin e nevojshëm sa i takon kriteret e procedurave të njohjeve të kualifikimeve.			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Nga takimi me studentët GVJ u informua se AFMM informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të tyre përmes sesioneve të informimit të detajuar para çdo fillim viti akademik.			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Referuar <i>Aneksit nr. 5-13-Rregullorja Tetor 2018</i> , AFMM informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës përmes Këshillit Akademik, Udhëheqësit të Punës Teorike dhe Njësisë së Produksionit për filmin e diplomës.			
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Referuar takimit me stafin akademik, rezulton se AFMM organizon çdo fillim viti akademik takime të hapura dhe konsultime për informimin e të interesuarve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

**Standardi V.3**  
**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit**


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
----------	------------------------	--	--	--





<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Referuar takimit me studentet dhe me stafin akademik, <i>Aneksave nr. 5-13 Rregullorja-Tetor 2018, nr. 80-Orari Java Pare 2018-2019</i> , studentët janë të informuar mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve për te 4 profilet e studimit qe ofron AFMM.			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Referuar <i>Aneksave nr. 5-13 Rregullorja-Tetor 2018, nr. 80-Orari Java Pare 2018-2019 si edhe nr. 14-Përshkrimi i Lendeve AFMM</i> , por edhe nga bashkëbisedimi me studentet, vlerësojmë se ky kriter përmbushet me standard nga AFMM. Informacioni u vihet në dispozicion studentëve që në fillimin e vitit akademik, për secilën prej lëndëve dhe moduleve përkatëse. I gjithë procesi i studimit i përmbahet planit të përcaktuar vjetor.			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	Referuar <i>Aneksit nr. 34-Shembull ofertë punësimi, mundësi specializime etj.</i> Institucioni informon vijimësisht, madje i integron studentët në tregun e punës. Regjistri i grupit Alumni përditësohet rregullisht nga drejtori administrativ.			
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Referuar <i>Aneksit nr. 45-BookPedia snapshot, 45-DVDPedia snapshot</i> dhe komunikimit me studentët vlerësojmë se ky kriter përmbushet. Të gjithë studenteve u vihet në dispozicion infrastruktura e nevojshme për të përmbushur qëllimin e modulit duke iu përmbajtur programit.			
<b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.	Institucioni disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit qe arrihet lehtësisht nga studentet.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi V.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.	Referuar <i>Aneksave nr.26-Lista e programeve me nr.studentësh, nr. 79-Diploma arkivi 2004_2018, 81-Statistika mbi diplomimet sipas profilit</i> , ne AFMM rezultojnë për vitin akademik 2018-2019: 5 studente në vitin e parë, 5 studentë në vitin e dytë, dhe 2 studente në vitin e tretë.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin	





zhvillohet programi i studimeve.									
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.	Referuar <i>Aneksit nr. 83-Dosjet e te diplomuarve</i> , për çdo student ka dosje personale me ecurinë gjatë programit të studimit, madje edhe për karrierën.								
<b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Institucioni nuk disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit.								
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Referuar <i>Aneksit nr. 37-38- Raportet vjetore 2012-2018</i> , rezulton se institucioni mban raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe mbi shkallën e cilësisë së punësimit të tyre.								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<b>Standardi V.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Referuar <i>Aneksit nr. 56-Vendim i këshillit studentor ne 2012, nr. 56-Zgjedhja e Kryetarit Kstud2018</i> si edhe nga bashkëbisedimi me studentet, rezulton se përfaqësuesi i zgjedhur i studentëve është i angazhuar, merr pjesë në mbledhjet e këshillit akademik si anëtar me të drejta të plota vendimmarrëse.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Referuar <i>Aneksit nr. 56-Vendim i këshillit studentor ne 2012, nr. 56-Zgjedhja e Kryetarit Kstud2018</i> si edhe nga bashkëbisedimi me studentët, vlerësojmë se përfshirja e studenteve në vendimmarrjet e Këshillit Akademik të AFMM apo edhe komisionet e ngritura për probleme të mbarëvajtjes së institucionit, janë të evidentuara.
<b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të	Referuar <i>Aneksit nr. 56-Vendim i këshillit studentor ne 2012, nr. 56-Zgjedhja e Kryetarit Kstud2018</i> si edhe nga bashkëbisedimi me studentet, merret parasysh edhe ngarkesa akademike e studenteve. Opinioni i studenteve merret në konsideratë gjatë vendimmarrjes në Këshillin Akademik dhe komisionet e ngritura nga AFMM.



studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.				
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.				
<b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Referuar <i>Aneksit nr. 62-Kërkesë nga studentët</i> , këshilli i përkohshëm i etikës dhe disiplinës i përbërë prej 3 anëtarësh ka një përfaqësues të zgjedhur nga Këshilli studentor.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi V.6</b>	
<b>Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Referuar <i>Aneks nr. 2-Statuti i AFMM 2018_MASR, 5-13-Rregullorja_Tetor 2018</i> , ne AFMM funksionojnë Njësia e Produksioneve dhe Drejtoria Administrative. Këto njesi, luajnë rolin e sigurimit të përmbushjes së cdo shërbimi për të cilin studentët kanë nevojë si edhe për mbarëvajtjen e shërbimeve të ofruara për studentët.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Në AFMM funksionojnë Njësia e Produksioneve dhe Drejtoria Administrative. Referuar <i>Aneks nr. 2-Statuti i AFMM 2018_MASR, 5-13-Rregullorja_Tetor 2018 si edhe Aneks nr. 56-Vendim i këshillit studentor ne 2012, nr. 56-Zgjedhja e Kryetarit Kstud2018</i> . Këto njësi garantojnë zgjidhjen e cdo problemi të studentit që lidhet me procesin mesimor, si edhe përmbushjen e standarteve sa më bashkëkohore të orëve të studimit.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor,	Ne AFMM funksionojnë Njësia e Produksioneve dhe Drejtoria Administrative. Referuar <i>Aneks nr. 2-Statuti i AFMM 2018_MASR, 5-13-Rregullorja_Tetor 2018</i> . Pranë këtyre sektoreve, studentët mund të informohen rregullisht për tregun potencial të punësimit apo të zhvillimit të praktikave në përputhje me programin e studimit.




zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.				
<b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Ne AFMM funksionojnë Njësia e Produksioneve dhe Drejtoria Administrative. Referuar <i>Aneks nr. 2-Statuti i AFMM 2018_MASR, 5-13-Rregullorja_Tetor 2018</i> , si edhe <i>Aneks nr. 29-Te dhënat për punësimin e studenteve</i> . Pranë këtyre sektorëve, ruhen informacionet mbi statistikat e studenteve të punësuar me perfundimin e programit të stuimit, si edhe transparencën e këtyre të dhënave.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

## VI.SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

<b>Standardi VI.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Referuar <i>Aneks nr. 30- Sigurimi i cilësisë, Aneks nr. 2-Statuti i AFMM 2018_MASR, 5-13-Rregullorja_Tetor 2018</i> , Këtë funksion e kryen Njësia e Produksionit dhe Këshilli Akademik. Këto njësi garantojnë përputhshmërinë e mbarëvajtjes së institucionit në fjalë konform legjislacionit të standarteve në fuqi.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Referuar <i>Aneks nr. 30- Sigurimi i cilësisë, Aneks nr. 2-Statuti i AFMM 2018_MASR, 5-13-Rregullorja_Tetor 2018</i> , Këtë funksion e kryen Njësia e Produksionit dhe Këshilli Akademik.. Vlerësojmë se institucionit i nevojitet një ekspert i jashtëm për sigurimin e dokumentacionit të vlerësimit të cilësisë.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë	Referuar <i>Aneks nr. 30- Sigurimi i cilësisë, Aneks nr. 2-Statuti i AFMM 2018_MASR, 5-13-Rregullorja_Tetor 2018</i> , vizitës në institucion dhe bashkëbisedimeve me studentet dhe stafin akademik të AFMM, këtë funksion e kryen Njësia e Produksionit dhe Këshilli Akademik. Vlerësojmë se institucionit i nevojitet një ekspert i jashtëm për sigurimin e dokumentacionit të vlerësimit të cilësisë.





cilësinë.				
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjve përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.	Referuar <i>Aneks nr. 30- Sigurimi i cilësisë, Aneks nr. 2-Statuti i AFMM 2018_MASR, 5-13-Rregullorja_Tetor 2018</i> , vizitës në institucion dhe bashkëbisedimeve me studentet dhe stafin akademik të AFMM, këtë funksion e kryen Njësia e Produksionit dhe Këshilli Akademik. Vetë fakti që provimet profesionale janë të hapura dhe i nënshtrohen gjykimit kolegjal në staf akademik, përbejnë një kondicion shumë të mirë për metodat krahasimore që sigurojnë cilësinë.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X


### Standardi VI.2

**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.	Referuar <i>Aneks nr. 30- Sigurimi i cilësisë, Aneks nr. 2-Statuti i AFMM 2018_MASR, 5-13-Rregullorja_Tetor 2018</i> , AFMM ka Njësine e Produksionit dhe Këshillin Akademik që kujdesen për zhvillimin koherent të programeve dhe kurrikulave mësimore, sigurisht duke respektuar dhe rekomandimet e ILA analoge me të cilat bashkëpunon ( rrjeti CILECT).			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.	Referuar <i>Anekseve nr. 40-Pyetësor 02/2019_Përgjigjet mbi lëndët_charts</i> , institucioni shqyrton dhe miraton, përmes mekanizmave e proceseve formale e të dokumentuara, programin e studimit. Këtë funksion e kryen Këshilli Akademik përmes sondazheve dhe anketave të herëpashershme.			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.	Referuar <i>Anekseve nr. 40-Pyetësor 02/2019_Përgjigjet mbi lëndët_charts</i> , vërejmë se në AFMM funksionon sistemi i anketimit dhe i sondazheve për zhvillimin koherent të programit mësimore.			
<b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Referuar <i>Anekseve nr. 40-Pyetësor 02/2019_Përgjigjet mbi lëndët_charts</i> , AFMM realizon analiza semestrale dhe vjetore të cilat i përcillen QSHA dhe MASR, si edhe partnereve homologe të CILECT dhe GECT.			
<b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.	Referuar <i>Anekseve nr. 40-Pyetësor 02/2019_Përgjigjet mbi lëndët_charts</i> , këtë standard AFMM e realizon përmes raporteve semestrale dhe vjetore.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X



<b>Standardi VI.3</b>	
<b>Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësi e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit është kryer në mënyrë periodike dhe është i përfshirë në raportin vjetor narrativ dhe financiar të institucionit. (AFMM si IAL me status të veçantë dhe strukturë të vogël institucionale nuk ka njësi të brendshme të cilësisë).
<b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.	Referuar <i>Aneks nr. 53- Filmat e studentëve</i> , citojmë metodologjinë dhe konkluzionin me provime të hapura publike, si edhe përballja në festivale kombëtare dhe ndërkombëtare të filmit studentor.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e e rregulluara dhe të tjera.	Njësia e produksionit është përgjegjëse për të gjithë proceset që lidhen me produksionin dokumentar dhe <i>fiction</i> (artistik) të filmave të studentëve. Stafi akademik është i predispozuar që çdo vlerësim të kryhet në bazë të meritokracisë, si edhe të përfaqësojë pjekurinë profesionale për çdo student. Metodatat e vlerësimit janë transparente dhe stafi i vlerësimit është i gatshëm për t'u bllafaquar për çdo mosdakordësi duke argumentuar çdo vlerësim pozitiv apo negativ për studentin. (Ref: <i>Aneks nr. 20-22- CV staf akademik</i> ).
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.	Referuar <i>aneksit nr. 40- Pyetësor anonim për studentët. Dhe aneksit nr. 53-Filmat e studentëve në festivale</i> . AFMM, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi siç janë sondazhet anonime me studentë aktivë dhe grupet Alumni.





Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

#### Standardi VI.4

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Referuar <i>aneksit nr. 47b- AFMM   The Faculty</i> , AFMM garanton përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Referuar <i>aneksit nr. 2- Statuti AFMM 2018-MASR</i> , vizits në IAL, bashkëbisedimit me studentët dhe stafit pedagogjik të institucionit, detyrat përcaktohen nga drejtori i AFMM (gjejmë me vend të vlerësojmë autoritetin dhe personalitetin artistik të këtij institucioni që përfaqësohet aktualisht nga Dr. K Ç).			
<b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.	Referuar <i>aneksit nr. 2- Statuti AFMM 2018-MASR</i> , vizitës në IAL, bashkëbisedimit me studentët dhe stafit pedagogjik të institucionit, rezulton se institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë. Këtë funksion AFMM e kryen përmes drejtorit të institucionit			
<b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit realizohet përmes respektimit dhe ruajtjes së integritetit akademik, duke shmangur çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. Vlen të përcaktojmë që personeli akademik i AFMM ka në përbërje profesionistë të spikatur të artit të filmit dhe televizionit në rrafsh kombëtar dhe më gjerë.			
<b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Referuar <i>aneksit nr. 47b- AFMM   The Faculty</i> , këtë kriter AFMM e realizon përmes bashkëpunimit me profesionistë të fushës përkatëse artistike dhe institucioneve partnere të rritit CILECT dhe GEECT.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht



**Standardi VI.5**


**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve								
<b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Referuar <i>aneksit nr. 47b- AFMM   The Faculty, aneksit nr. 2- Statuti AFMM 2018-MASR, 5-13-Rregullorja_Tetor 2018</i> , për këtë standard kujdeset zyra e administrimit e cila është e aksesueshme nga çdo individ apo institucion qe ka interes dhe impakt direkt apo indirekt me AFMM.								
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Referuar <i>aneksit nr. 61-Dosjet nga stud-Filmat e fundvitit afishimet si edhe ofrojmë shembuj ne faqen ëeb AFMM-Admission; AFMM-The Faculty; AFMM-Students Film_Aëards 2018</i> , vizitës në institucion, bashkëbisedimit me stafin pedagogjik dhe studentet, si edhe administrimit online te projekteve artistike të studentëve si detyrime semestrale apo vjetore, por edhe dokumentacionit për pjesëmarrje në evente kombëtare dhe ndërkombëtare vlerësojmë se AFMM e përmbush këtë kriter.								
<b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	AFMM ndjek strategjinë e implementimit të rekomandimeve që ndihmojnë në rritjen e nivelit të rezultateve të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm, sigurisht konform programeve dhe rekomandimeve të CILECT.								
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Referuar <i>aneksit nr. 30- Sigurimi i cilësisë, aneksit nr. 2-Statuti i AFMM 2018_MASR, 5-13-Rregullorja_Tetor 2018, aneksit nr. 61-Dosjet nga stud-Filmat e fundvitit afishimet si shembujve ne faqen ëeb AFMM-Admission; AFMM-The Faculty; AFMM-Students Film_Aëards 2018</i> , këtë funksion e kryen Njësia e Produksionit dhe Këshilli Akademik. Provimet e hapuara dhe ndjekja permanente nga profesioniste dhe institucione artistike të fushës, sigurojnë zhvillimin e mëtejshëm të këtij standardi.								
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Referuar <i>aneksit nr. 30- Sigurimi I cilësisë, Aneks nr. 2-Statuti i AFMM 2018_MASR, 5-13-Rregullorja_Tetor 2018</i> , këtë funksion e kryen Njësia e Produksionit dhe Këshilli Akademik. Kjo realizohet përmes përditesimit me praktikat e ndjekura në institucionet simotra në vendet më të zhvilluara të botës, duke u përpjekur të implementohen të gjithë elementët e nevojshëm që e bejnë mësimdhënien sa me kontemporane si edhe duke lehtësuar metodat e ndjekura për mësimnxënien. Synohet që cdo vit të ketë përmirësime progresive në cilesinë e programit të studimit.								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						





Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X





**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor "Specialist i Lartë në Film dhe Media" me profile: a. Regjisorë; b. Skenar; c. Kamera; d. Montazh."Akademia e Filmit dhe Multimedias Marubi**

**Pikat e forta dhe afirmime:**

1. AFMM disponon mjedise dhe laborator të një niveli të lartë teknologjik dhe sipas të gjitha standardeve europiane.
2. AFMM përveç se një institucion edukimi artistik është edhe një ndërmarrje e prodhimeve dhe produksioneve artistike filmike dhe televizive.
3. Mobiliteti i studentëve është i garantuar nga marrëveshjet me Universitete homologe në BE.

**Pika të dobta:**

1. Programe e Syllabuse të lëndëve të pa detajuara.
2. Mungesa e një specialisti për sigurimin e dokumentacionit të vlerësimit të cilësisë.
3. Mungesa e një qasje më bashkëpunuese me Universitetet homologe të rrafshit kombëtar.

**Rekomandime:**

1. Detajimi i Syllabuse-ve dhe programeve të lëndëve.
2. Rekrutimi me kohë të pjesshme i një specialisti për sigurimin e dokumentacionit të vlerësimit të cilësisë.
3. Ndërtimi i marrëdhënieve të qëndrueshme me IAL kombëtare të të njëjtit profil akademik.
4. Nxitja për kualifikim shkencor për personelin e ri akademik që AFMM rekruton me kohë të plotë apo të pjesshme .



**Conclusions on the Evaluation of the Bachelor Study Program in “Senior Specialist in Film and Media” with profiles: a. Directing; b. Screenplay; c. Camera; d. Editing. “Academy of Film and Multimedia “Marubi”.**

**Strengths and Affirmations**


1. AFMM has high technological level facilities and laboratories according to all European standards.
2. AFMM besides being an art education institution is also an enterprise of artistic, filmic and television productions.
3. Student mobility is guaranteed by agreements with counterpart universities in the EU.

**Weaknesses**

1. Unspecified programs and course syllabuses.
2. Lack of a specialist to provide quality evaluation documentation.
3. Lack of a more collaborative approach with counterpart Universities on a national level.

**Recommendations**

1. Detailing of syllabuses and course programs.
2. Part-time recruitment of a quality assurance specialist.
3. To build lasting relationships with national HEIs of the same academic profile.
4. Promotion of scientific qualification for new academic staff that AFMM recruits full or part time.





Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

